



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i integruar i studimit i ciklit të dytë
Master i Shkencave në “Arkitekturë”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë
Universiteti i New York-ut në Tiranë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Jonida Meniku

2. Dr. Diana Bardhi

Nëntor 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave/ Program i Integruar i Nivelit të Dytë në “Arkitekturë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut në Tiranë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave (PI) në “Arkitekturë”
4	Urdhëri/ VKM i licencimit:	UMASR Nr. 237, datë 15.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për here të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	2020-2021 raporti 7 PAE/ 2 PAK 2021-2022 raporti 10 PAE/ 3 PAK 2022-2023 raporti 13 PAE/ 4 PAK 2023-2024 raporti 16 PAE/ 4 PAK 2024-2025 raporti 18 PAE/ 7 PAK
18	Numri i studentëve: (2020- 2025)	79 studente
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë” është licensuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Urdhër nr. 237, datë 15.07.2020, dhe ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitektures të “UNYT”.

Ai i përket Ciklit të Dytë të studimeve që korrespondon në Nivelin 7 të Arsimit të Përgjithshëm sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ky program studimi është konform pritshmërive të Nivelit 7: Ligj Nr. 10247, datë 04.03.2010.

Qëllimi i tij është përgatitja me e specializuar e arkitektëve, të aftë për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë, me mundësi integrimi në një kontekst shumë disiplinor, si në sektorin e punësimit privat, ashtu dhe atë publik; duke përfshirë të gjitha aspektet arkitektonike, konceptuale dhe kompozicionale në krijimin e hapësirave të jashtme dhe të brendshme, dizajnin e interierit përmirësimin estetik të mjediseve ndërtimore, funksionin e tyre, përfshire edhe njohuritë konstruktive. Ky program synon në aftësimin e profesionistëve të rinj, për drejtimin e menaxhimin e projekteve të godinave rezidenciale, komerciale dhe institucionale, si dhe planifikimin e qyteteve të qendrueshme, trajtimin e hapësirave publike e private, duke nxitur kështu zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar.

GVJ konstatoi nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës, Aneksi 1.10 Rregullorja e Programit MSc Arkitekturë 2024” dhe Statuti i Miratuar 2025, se Programi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, të parashikuara në Kapitullin A, Neni 1 (Rregullorja) si dhe tek shtyllat e strategjise së zhvillimit të programit.

Ky program studimi ka kohëzgjatje normale të programit në 5 vite akademike, dhe 300 kredite ECTS, ku viti akademik është i ndarë në dy semestra.

Programi i studimit, Cikli i Dytë Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë” ka filluar me gjeneratën e parë në vitin akademik 2020-2021 dhe vazhdon deri me sot.

UNYT me themelimin e tij ka krijuar bashkëpunime me institucione prestigjioze si Universiteti Shtetëror i Nju Jorkut/Empire State College (SUNY/ESC) në SHBA, me Universitetin e Greenwich në Mbretërinë e Bashkuar (MB), etj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësimit të jashtëm, mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar së bashku me RVB si dhe në intervistat me stafin dhe dokumentet e vëna në dispozicion gjatë vizitës së kryer pranë ambienteve të "UNYT", konstatoi se njësia bazë, Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit pranë Fakulteti të Inxhinierisë dhe Arkitekturës të UNYT, kanë në përbërje të tyre staf akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Secila njësi bazë plotëson kushtet e përcaktuar nga ligji ku minimumi tre pjesëtarë të stafit akademik të jenë me gradën shkencore "Doktor".

Gjithashtu u konstatua se profili i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet më së miri me programin Master i Shkencave në "Arkitekture". Kjo ndikon në përmbushjen e standardeve të programit.

Vihet re se edhe stafi i cili është angazhuar me kohë të pjesshme është një staf i kualifikuar dhe profesionist në fushën që mbulon. Kjo bën të mundur ofrimin e një aspekti praktik dhe konkret të organizimit të programit.

Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Personel Akademik me Kontratë përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të angazhuar nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Dr. Jonida Meniku dhe Dr. Diana Bardhi. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga koordinatori teknik e ASCAL, Msc. Aviola Bardhi.

Më datë 28.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 150/18 Prot., datë 28.10.2025, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

UNYT kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 30.10.2025 dhe me shkresë me nr. 95/1 prot, datë 29.10.2025 ku shprehet se janë dakord me sugjerimet e lëna.

Sa më sipër, drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të integruar të Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencave në “Arkitekturë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Hapja e Programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë” është licensuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Urdhër nr. 237, datë 15.07.2020, dhe ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitektures të UNYT. Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (Aneks 1.1- Statuti i UNYT), (Aneks 1.2 - Misioni dhe Objektivat) dhe (Aneks 1.6 – Plani Strategjik), ky program studimi është hartuar për të adresuar nevojat kombëtare, për të kontribuar në vlerësimin dhe ruajtjen e trashëgimisë e kulturës shqiptare, për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmbushur kërkesat për integrimin evropian. Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë”, ka synim themelor veprimtaritë formuese dhe edukuese të specialistëve në fushën e Arkitekturës, që kanë të bëjnë me aspektet arkitektonike, konceptuale dhe kompozicionale në krijimin e hapësirave të jashtme dhe të brendshme, funksionin e tyre, përfshirë edhe njohuritë konstruktive, aplikimin e koncepteve inovatore për hapësirat urbane dhe rurale, në transformimin pozitiv të shoqërisë, dhe përmirësimin estetik të mjediseve ndërtimore, duke dhënë kontribut të rëndësishëm e duke influencuar në politikat publike. Konteksti i pasur i qyteteve shqiptare me vepra të rëndësishme të arkitekturës tradicionale përbëjnë pasuri kulturore kombëtare, të cilat janë motivim dhe frymëzim për ruajtjen, ndërtimin, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore arkitekture, dhe kjo mund të arrihet edhe më tej duke krijuar profesionistë të mire të fushës së Arkitekturës. Programi i Integruar i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Arkitekturë” është ndërtuar t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm. Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nepërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit shkencor dhe veprimtarive edukative.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Qëllimi i programit MSc në Arkitekturë-PIND, ashtu siç edhe është paraqitur në RVB, është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit të New York-ut në Tiranë, për të përgatitur studentët profesionalisht si ekspertë në fushën e Arkitekturës, e cila ka marrë mjaft rëndësi vitet e fundit, për të ndikuar në rritjen e kulturës urbane, menaxhimin e projekteve të godinave rezidenciale, komerciale dhe institucionale, si dhe planifikimin e qyteteve të qëndrueshme dhe të tyre;

	një gjeneratë e re profesionistesh, me përgjegjësi sociale, me mundësi integrimi në një kontekst shumëdisiplinor si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik, në Shqipëri dhe më gjerë. Ky program studimi, referuar edhe takimeve në institucion, ka kërkesa në rritje, kjo edhe falë interesit të jashtëzakonshëm në dekadën e fundit nga investimet e shumta private e publike në Tiranë dhe zonat bregdetare, si dhe politikat e urbanizimit që synojnë modernizimin e infrastrukturës dhe hapësirave urbane. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë faktorë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të eksperteve si arkitektë, urbanistë dhe dizajnere të interiorit, të cilët mund ti shërbejnë kërkesave të tregut të punës, dhe zgjerimit të ofertës akademike nga ana e universitetit, referuar shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, paraqitur në Aneks 1.1.1 dhe Aneks 1.8.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	GVJ vlerëson se nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (Aneksi 1.10 Rregullorja e Programit MSc Arkitekturë 2024" dhe Statuti i Miratuar 2025), u konstatua se: Programi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, të parashikuara në Kapitullin A, Neni I (rregullorja) si dhe tek shtyllat e strategjisë së zhvillimit të programit. Vizioni i këtij Programi Studimi është në përputhje me drejtimet akademike të universitetit, duke u mbështetur në arritjet me të fundit shkencore, inovatore dhe vizioneve kërkimore, në aspektin e përgatitjes së eksperteve të aftë për tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit MSc në Arkitekturë-PIND në UNYT, rezulton që është konceptuar për të avancuar në prioritetet e zhvillimit kombëtar, në mbështetje të trashëgimise kulturore dhe në përmbushje të standarteve globale të qëndrueshmërisë, dhe në përshtatje me kornizat kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë vizitës në Institucion, si dhe në RVB syllabuset e programit dhe planet mësimore, si dhe Aneks 2.4 (Strategjia 2023-2028) u konstatua se politikat dhe objektivat e Programit të studimit zhvilluar nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit në UNYT, janë hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe prirjet globale, që kanë fokus kryesor fushën e arkitekturës së qëndrueshme, zhvillim urban të qëndrueshem dhe ruajtjen e trashëgimise kulturore (Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshem të Kombeve të Bashkuara (SDGs 11- Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme). Nga IAL cilësohet se ky program studimi fokusohet në: parimet e dizajnit të qëndrueshem, sfidat ndërkombëtare arkitekturore, praktikat etike të projektimit, urbanizimi dhe diversiteti kulturor, ndryshimet klimaterike, energjitë e rinovueshme dhe integrimi teknologjik e dixhital, duke u mbështetur edhe në planin kombëtar për Integrimin Evropian dhe Plani i Veprimit për Rininë 2022-2029.
Konkluzione	<i>Institucioni ofron Programin e Integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Arkitekturë" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Gjatë vizitës por dhe shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se ky program përputhet plotësisht me misionin dhe objektivat e Institucionit. Studentët janë fokusi parësor i IAL dhe inkurajohen që të luajnë rol aktiv në përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit duke</i>

	vlerësuar mësime të mësuara, rezultatet e nxënies dhe duke i ushtruar kompetencat e tyre në projekte të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit hartohet dhe ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit pranë Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës të UNYT. GJV vërejtë se personeli akademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës të UNYT, është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar realizimin e objektivave të programit të Integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave - PIND në "Arkitekturë". Nga dokumentacioni i paraqitur dhe bisedat gjatë vizitës në IAL, vihet re se kapacitetet përputhen me kurrikulën, me fushën e specializimit të stafit akademik vendas dhe të huaj, si dhe përmbajtjen infrastrukturore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), rekomandon që institucioni mund të angazhohet më tepër me çështje si: Ndërkombëtarizimi i programit, zhvillimi i aktiviteteve shkencore institucionale dhe me bashkëpunime ndërkombëtare, organizata profesionale, komunitetin e biznesit etj. Botime në gjuhën shqipe dhe të huaj, tituj akademik të fituar, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, si dhe përfshirja në projekte ndërkombëtare, të cilat duhet të dëshmojnë që UNYT ka përvojën e duhur, burimet e duhura në fushën akademike, për këtë program studimi. Burimi: Aneksi 1.10.1 - Rregullore e Programit MSc Arkitekture '24 Aneksi 1.12 - Evente, Leksione të hapura, Seminare 2020-2024 Aneksi 1.13 - Workshope 2020-2025 Aneksi 1.6.1 - Plani Strategjik 2026-2030
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ vërejtë nga shqyrtimi i dokumentacionit, se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, profili "Arkitekturë" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe përkon me Nivelin e 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion, por edhe në vlerësimet institucionale të UNYT, u konstatua se IAL ka në përbërje të tij Departamentin e Arkitekturës dhe Dizajnit. Ky departament është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe si i tillë përputhet plotësisht me fushën akademike e kërkimore që njësia ofron. Ky program, si pjesë e vizionit dhe misionit të Departamentit, synon të pajisë studentet me njohuri teorike dhe praktike, për tu bërë të aftë dhe konkurrense për sfidat e tregut të punës si dhe për të formuar arkitektë lider në zhvillime të qëndrueshme dhe inovative. IAL ka të themeluar disa organe kolegjiale të cilat sigurojnë funksion të mirë të Institucionit sikur janë Këshilli i Etikës, Asambleja e Stafit Akademik, NJSBC, Qendra e këshillimit për studentët.

	Ky program studimi është hartuar sipas klasifikimit/ kodifikimit, konform udhëzimeve kombëtare dhe evropiane, dhe ka kodin 75M1073A, me një kohëzgjatje prej 5 vitesh akademike dhe përmbushje të 300 krediteve ETC. Burimi: Aneksin 1.1.1 – Organigrama Aneksi 1.3 - Plan i mesimor MSc Arkitekture Aneksi 1.4 - Kodifikimet Aneksi 2.2 - Syllabuset
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion, për programin e ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekture”, GVJ konstaton se ky program është nën përgjegjësinë e Fakultetit të Inxhinjerisë dhe Arkitekturës, i cili rezulton të jetë një staf i kualifikuar dhe me përvojë në këtë fushë. Në fund të këtij cikli studentët pajisen me diplomë universitare, pas një trajnimit akademik të avancuar, duke promovuar edhe kërkimin shkencor. GVJ konstaton se departamenti ofron dy programe studimi në nivelin bachelor: a. Bachelor në Dizajn me profile në Grafike Dizajn dhe Interior Dizajn dhe b. Master i shkencave (PI) në Arkitekturë. <i>GVJ rekomandon të ketë një qasje më tepër ndërkombëtare, ku mund të krijohen mundësi për bashkëpunime dhe kontakte të drejtpërdrejta në burime dhe njohuri të avancuara për shkencën, kërkimin shumë disiplinor dhe mësindhënie, apo edhe për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UNYT.</i> Burimi: Aneksin 5.28 – Programet e studimit Aneksi 3.11.1 Supplement diplome
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N/A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Mbështetur në RVB por edhe në takimet e ndryshme të realizuara gjatë vizitës në institucion, duke u mbështetur në misionin e UNYT, vlerësojmë se përmbushet synimi për të ofruar trajnime profesionale, praktika të ndryshme në kompani ndërtimi apo edhe studio projektimi, (p.sh. Kumi Construction, Kastrati Construction, XPlan studio, Atelier 4 etj.) si dhe vizita studimore në showroom-e apo panairë. UNYT, inkurajon dhe mbështet studentet për tu aftësuar më tej, nëpërmjet kurseve të ndryshme profesionale. Burimi: Aneksi 5.19.2 - Mundësi punesimi dhe praktike Aneksi 5. 20 – Statistika mbi punesimin e studenteve
Konkluzione	<i>Nga dokumentacioni i depozituar, si dhe nga bisedat gjatë vizitës në IAL, ky program studimi është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Institucioni garanton sigurimin e cilesisë për programin që ofron.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ konstaton që UNYT organizon kryerjen e aktiviteteve në bashkëpunim me institucione, kompani, palë të treta dhe aktorë të biznesit vendas e të huaj. Vetë organizimi dhe funksionimi i grupeve e kërkon krijim e shkëmbimin e informacioneve. Rezultatet e arritura, dhe standartet e larta konfirmojnë funksionimin e bashkëpunimit dhe dobinë e shkëmbimit të informacionit, duke u bazuar në përgjegjësitë e ndara dhe analizat e vazhdueshme. Vërehet se në këtë institucion realizohet bashkëpunimi dhe ndërveprimi mes anëtarëve të stafit si në nivel departamenti, fakulteti ashtu dhe në nivel institucioni. Përvoja e fituar dhe cilësia e arritur, inkurajojnë nisma të përbashkëta, për projekte kërkimore, publikime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, por dhe duke u kujdesur për një jetë të pasur sociale që kuron dhe marrëdhëniet e mira personale mes tyre.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	GVJ konstaton nëpërmjet dokumentacionit të depozituar që UNYT ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe partneriteti me organizma të ndryshme publike dhe private, që plotësojnë gamën e njohurive profesionale nga ana e studentit, konform objektivit Strategjik 3 "Ruajtja dhe përmirësimi i rrjetit të partnereve dhe marrëdhënieve". Institucioni ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me Universitetin e Arteve, me MoUPolis dhe Calabria University, për realizimin e leksioneve të hapura të përbashkëta, workshope, projekte kërkimore në fushën e arkitekture tradicionale sic ishte edhe rasti i Universiteti Yiltiz në Turqi, apo thirrje të përbashkëta për projekte bilaterale, si psh projekti bilateral me Kolegjin AAB Prishtinë. Programet kryesore ku UNYT merr pjesë janë Mou Mevlana dhe Erasmus+, duke arritur marrëveshje mirekuptimi dhe bashkëpunimi me disa institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Rezulton se UNYT është pjesë e shoqatës së Universiteteve Evropiane (EUA), dhe pjesë e shkollave ndërkombetare të rrjetit MAARIF në 67 shtete të ndryshme me 440 institucione edukimi. Burimi: Aneksi 1.6 Plani Strategjik 2020-2025 Aneksi 1.20, 1.20.1 Polis dhe Calabria University. Aneksi 1.19 Lista Mevlana dhe Erasmus + Aneksi – Komunikim mbi propozimin e kompanive për intership.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konkludon që IAL ka një rrjet partnerësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët kontribuojnë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të bashkëpunimit me këta partnerë real me objektiva afatgjata strategjike,

institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	aty ku UNYT, ofron programe akademike të përbashkëta dhe qendra kërkimore. GVJ-së ju komunikua se për të gjitha bashkëpunimet IAL ka kontrata bashkëpunimi, për realizimin e të cilave hartohet një raport ku evidentohen dhe përfitimet në funksion të realizimit të programeve të studimeve, me fokus fushën e Arkitekturës. Burimi: Aneksin 5.10 – Lista e MoU Aneksi 1.26 Efektiviteti i Marrëveshjeve të bashkëpunimit Aneksi 1/22 Internship report Aneks 1.1 Study field trips 2020-2025			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Gjatë diskutimeve në Institucion, dëshmohet se Departamenti i Arkitekture dhe Dizajnit, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës të UNYT, harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për cdo program studimi. Burimi Aneksit 1.22/3 të Internship report. evaluation Supervisor			
Konkluzione	<i>Partnerët me të cilët bashkëpunon UNYT, dhe lloji i bashkëpunimit me to, dëshmojnë që studentët përfitojnë njohuri të mira profesionale.</i> <i>Rekomandohet që IAL të zgjerojë rrjetin e saj të marrëdhënieve dhe partneriteteve, praktikat profesionale të jenë në fokus të marrëveshjeve që universiteti në bashkërendim me fakultetin dhe departamentin realizon.</i> <i>Këtu përfshihen edhe marrëveshjet me komunitetin e biznesit, bashkitë në vend, si dhe me agjenci private dhe joqeveritare apo komunitete administrative të cilat kanë në fokus praktikat profesionale dhe ofertën e shërbimeve. Universiteti i UNYT ka vendosur marrëdhënie të konsoliduara partneriteti me aktorë që ndikojnë në realizimin e objektivave strategjike afatgjata të institucionit.</i> <i>Rekomandohet organizimi i forumeve, konferencave, publikimi i aktiviteteve shkencore (artikuj, kumtesa, referate, botime etj) të cilat do të shërbenin për njohjen dhe vlerësimin më të gjerë të departamentit, duke rritur mundësinë e bashkëpunimeve, rritjen e kërkimit shkencor tek stafi, dhe përdorimin e këtyre arritjeve në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi, Master i Shkencave (Programi i Integruar), në “Arkitekturë”, zhvilluar nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, në Fakultetin e Inxhinierise dhe Arkitekturës, duke u mbështetur në misionin e UNYT, përmbush synimin për të ofruar studime të ciklit të dytë në fushën e Arkitekturës në përputhje të plotë me Misionin e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, si dhe me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore kombëtare në fuqi. Ky program është ndërtuar në respekt dhe zbatim të Ligiit për Arsimin e Lartë si dhe aktet e tjera për të pasur një pajtueshmëri të plotë me to. Lëndet brenda këtij program përcaktohen me kredite ECTS, ku numri i tyre për semester është 30 ECTS (për një vit akademik është 60 ECTS). Studimet e Ciklit të Dytë të integruar përmban 300 ECTS për të pestë vitet e studimit. Emërtimi i programit të studimit është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Programi i studimit, referuar të gjithë dokumentacionit të paraqitur, përmban të gjitha elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit. Kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë; Planin mësimor; Kuotat; Syllabus. Burimi: Aneksi 2.1 Tabelat përmbljedhese
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UNYT (dosja dhe materialet plotësuese) nga ana e GVJ, konfirmojmë angazhimin tërësor të hallkave përgjegjëse në këtë institucion për realizimin e qëllimit të këtij Programi studimi. Fakt ky që u vu re edhe gjatë bisedave me studentët dhe personelin akademik, ku u informuam për objektivat kryesore të IAL-se. Bazuar në profilin institucional UNYT, GVJ vlerëson se Institucioni siguron dhe garanton specializim të thelluar të studentëve në fusha të njëjta dhe/ose të përafërta, nëpërmjet njohurive teorike dhe praktike në fushën e Arkitekture. GVJ shqyrtoi me kujdes planin mësimor të Programit MSc në Arkitekturë: (syllabuset e lëndëve, leksione teorike, seminare, workshope, tutorial, simulime, debate ekspozita, përdorimi i laboratorëve, punimet diploma të studentëve si dhe vlerësimin nga Alumni) dhe gjykon që realizimit të këtij objekti i është kushtuar vëmendja e duhur dhe realizmi i tij është në nivel të mirë. Ky program studimi ka për qëllim përgatitjen e ekspertëve - arkitekte shqiptar, si pjesë e tregut Evropian, pasi konkurrenca e tyre nuk do të jetë vetëm në tregun e punës brenda vendit, por në një kontekst shumë më të gjerë. Programi ka në fokus zgjidhjen e kërkesave bashkëkohore globale, rajonale e vendore, përditesimin me zhvillimet me te reja në fushën e Arkitekturës dhe Ndërtimit, për qyteteve të qëndrueshme,

	funkionale, dhe në shërbim të rritjes së cilësive të jetës. <i>GVJ vlerëson përpjekjet e deritanishme dhe sugjeron ndërkombëtarizimin e mëtejshëm të këtij programi studimi.</i> Burimi: Aneksi 1.12 Evente, Leksione të hapura, Seminare 2020-2024
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ vlerëson në mënyrë të veçantë koherencën e planit mësimor jo vetëm për konkretizimin e njohurive teorike por edhe për krijimin e një bazë të dhënash në mbështetje të aktiviteteve kërkimore - shkencore, si dhe përvojat e institucionit në marrëdhëniet me tregun e punës, duke krijuar mundësi reale punësimi për këtë profesion të rendesishëm në vendin tonë. Nga analiza e ndarjes së ECTS sipas formave të mësimdhënies, GVJ pasi konsultoi planin mësimor, konstaton se ka raporte të drejta ndërmjet formave të mësimdhënies. Bazuar në dokumentacionin e depozituar, kryesisht në Rregulloren e programit të studimit, Planin mësimor e silabuset, programi ka 300 kredite. Përgatitja e diplomës kanë 12 kredite-Projekt Diploma, ose 4% të peshës totale. Bazuar në dokumentacionin e Rregullores së Diplomës për Programin e Studimit, me 4 kredite vlerësohet Internshipi ose Praktika Profesionale, e cila zhvillohet njëherë në vit të tretë dhe njëherë në vit të katër, duke arritur me 8 kredite (ECTS) gjithsej. Nga dokumentacioni i paraqitur, u konstatua se UNYT ofron praktika profesionale në bashkëpunim me kompani të ndryshme apo studio projektimi. Pas përfundimit të praktikës mbikëqyesi i kompanisë vlerëson performancën dhe kontributin e përgjithshëm të studentit dhe dorëzon një raport akademik. Nga ana tjetër student dorëzon një portofol të punimeve të kryera, i cili vlerësohet me notë. Burimi: Aneksin 1.22 – Internship report Aneksi 1.3 Plani mësimor MSc Arkitekture Aneksi 1.10 Rregullore e Programit 2024
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës	N/A



fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të bëra në institucion, GVJ konkludon që forma e organizimit dhe pranimi i studentëve rezultojnë të jenë konform Ligjit të Arsimit të Lartë dhe kuadrin ligjor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kuotat e pranimit në programin e studimeve Master i Shkencave në "Arkitekture" miratohen me vendim Senati, dhe kualifikohen vetëm ata kandidatë të cilët plotesojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë, sipas akteve nenligjore dhe kriterëve shtesë universitare në Republikën e Shqipërisë. UNYT pranon edhe studentë me nënshitetësi të huaj duke ndjekur procedurat e njohjes së diplomes dhe ekuivalentimit sipas legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi. Burimi: Aneksi 1.10 – Rregullore e Programit 2024 Aneksi 5.2 Vendim Senati
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ bazuar në dokumentacionin e dërguar (objektivat e këtij programi studimi), del në përfundimin se: Ky program studimi ka shume ngjashmeri, se paku 70% me programet e Universitetit Polis dhe Universitetit Barleti. Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master ne Arkitekturë, që ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës të UNYT dhe Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit rezulton se ka nje kombinim të lëndëve teorike dhe praktike, me fokus në zhvillimin e aftësive projektuese dhe teknike të studenteve. Dizajn Arkitekturor, Histori e Arkitekture, Artit dhe Dizajnit Urban, Dizajn Kompjuterik, Vizatim Teknik, Statistike dhe Teori Strukturash, Planifikim Urban, Mjedis i Qendrueshem, Intership dhe Projekt Diplome. Lëndët me zgjedhje kryesisht janë të ndryshme. Burimi: Aneksi 1.3 Plani mesimor MSc Arkitekturë
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konkludon që Programi i studimit Master i Shkencave ne "Arkitekture" përkon me Nivelin e programit sipas Kornizes Shqiptare të Kodifikimit – Niveli 7; dhe mban kodin 75MS0731A. Burimi. Aneksi 1.3 Plani mesimor Aneksi 1.4 Kodifikimet, Kodi i Programit
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A
Konkluzione	GVJ, gjatë vizitës në institucion, pasi konsultoi objektivat e Programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (Program i Integruar) në "Arkitekturë", konkludon që Procesi mësimor, kërkimor-shkencor dhe





	<i>administrativ organizohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Ky program studimi i ciklit të dytë mban kodin 75MS0731A.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së bërë në institucion, rezulton që ky program ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencor prane fakultetit të Inxhinierise dhe Arkitekturës, i cili përfshin tri njësi bazë: 1. Departamenti i Shkencave Kompjuterike 2. Departamenti i Sistemeve të Informacionit dhe Inteligjente 3. Departamenti i Arkitekture dhe Dizajnit Fakulteti është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor. Departamenti është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe punës kërkimore – shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplina mësimore respektive. Konstatohet se Institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe rezulton të ketë një staf të kualifikuar në fushat arkitektonike dhe urbane.

Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së bërë në institucion, rezultojnë që departamenti është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies. GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionin në dispozicion vuri re se Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, përmbush detyrimet e caktuara në legjislacionin në fuqi. Ai angazhon stafin ndihmës akademik dhe administrativ për zhvillimin e orëve laboratorike apo edhe praktikave mësimore. Laboratori qëndron në gadishmeri të studentëve dhe të stafit pedagogjik për praktika dhe kërkime shkencore, brenda këtij program studimi. Stafi në departament: - Për vitin akademik 2020- 2021 departamenti ka patur 9 (2 Prof, 2 Prof as, 5 Dr) personel akademik efektiv dhe 0 personel akademik me kontratë. - Për vitin akademik 2021- 2022 departamenti ka patur 7 (1 Prof, 5 Dr, 1 Msc) personel akademik efektiv dhe 0 personel akademik me kontratë. - Për vitin akademik 2022- 2023 departamenti ka patur 10 (7 Dr, 3 Msc) personel akademik efektiv dhe 5 (1 Dr, 4 Msc) personel akademik me kontratë. - Për vitin akademik 2023- 2024 departamenti ka patur 10 (7 Dr, 3 Msc) personel akademik efektiv dhe 9 (2 Dr, 7 Msc) personel akademik me kontratë. - Për vitin akademik 2024- 2025 departamenti ka patur 8 (6 Dr, 2 Msc) personel akademik efektiv dhe 10 (2 Dr, 8 Msc) personel akademik me kontratë. Burimi: Aneksi 2.1 Tabelat përmbledhëse			
Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Dokumentacioni që konsultoi GVJ (dosja dhe materialet plotësuese) konfirmojnë se drejtuesi i departamentit sigurohet që detyrat drejtuese akademike dhe administrative të departamentit të shpërndahen në menyre të drejte, për të mundësuar zhvillimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve. Burimi: Aneks 1.8 Rregullore Fakulteti të Inxhinierisë dhe Arkitekturës			
Konkluzione	GVJ gjykon se Institucioni organizohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Kjo strukturë ka arritur gjithmonë duke u zgjeruar me qëllim zbatimin e nevojave institucionale, kërkesave ligjore dhe standardeve të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e	Në takimet me stafin dhe duke u bazuar në dokumentacionin përkatës (Statutin e Institucionit dhe Rregulloret e Përgjithshme) konstatohet se



studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave (program i integruar) në Arkitekturë. Vlerësojmë se anetaret e stafit të kësaj njësie janë plotësisht të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programit. Institucioni garanton siguri, e cila vjen si rezultat i eksperiences disa vjecare të UNYT. Burimi: Aneksi 1.3 Plani mesimor Aneksi 1.9 Rregullore e departamentit të arkitekturës dhe dizajnit Aneksi 2.4 Strategjia e zhvillimit të programit
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mesimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mesimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.	Nga verifikimi i dosjes së paraqitur, në Aneksin 1.3 dhe 2.1 rezultojnë që programi i studimit është i ndarë në pesë vite studimi. Cdo semester ka 30 kredite ECTS dhe në përfundim të pesë viteve studentët grumbullojnë 300 ECTS. Programi është i organizuar në pesë kategori përkatëse: Kategoria A- Lëndë Bazë 15% - 20% (kredite) – 19.33 %. 10 lëndë Kategoria B- Lëndë karakterizuese 45% - 55% (kredite) 54.67%. 25 lëndë Kategoria C- Lëndë Ndërdisciplinore/Integruar 12% - 15% (kredite) – 14.67 %. Kategoria D- Lëndë me zgjedhje, 6% - 8% (kredite) – 7.33%. Kategoria E -Detyrime Përmblylëse 3% - 5% (kredite) - 4 % me kohëzgjatje normale 5 vite akademike, ku cdo semester ka 30 kredite ECTS dhe në përfundim të pesë viteve studentët grumbullojnë 300 ECTS. Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra. I vit akademik ka 30 javë mesimore në auditor. I semestër ka 15 javë mesimore në auditor. I ECTS — 25 orë mesimore punë të studentit. I orë mesimore = 50 minuta Referuar dokumentacionit të depozituar, në Rregulloren e programit të studimit, Planin mesimor e silabuset, GVJ vlerëson se struktura e programit, është e plote dhe e qartë, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesa mesimore e lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit. Grupi i Vlerësimit Jashtëm (GVJ) konstaton se personeli akademik dhe ai mbështetës janë profesionalisht të kualifikuar dhe përmbushin standardet për programin, por duhet të rishikohet ngarkesa dhe ndarja e detyrave mes personelit akademik dhe disiplina në të cilat ai angazhohet. Burimi: Aneksi 2.2. Syllabset Aneksi 2.1 Tabelat përmbledhese Aneksi 1.3 Plani mesimor
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin e depozituar, kryesisht në Rregulloren e programit të studimit, Planin mesimor e silabuset, vlerëson se struktura e programit, lëndët, emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, pranimi i studenteve dhe kërkesa për gjuhën angleze është në përputhje me profilin e programit. Programi i studimit, Masteri i Shkencave në Arkitekturë, përmbush kriteret, ku lexohen qartë rregullat për pranimin, transferimin

	dhe ekuivalentimin e studimeve, në përputhje me Aneksin 1.10 – Rregullore e Programit MSc Arkitekturë. Burimi: Aneks 1.10. Rregullore e programit, MSc Arkitekture 2020 Aneks 2.9 Politika e transferimit të studimeve Aneks 2.20 Propozim për transferim			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit, i syllabuseve, programi qëndron në përputhje me legjislacionin në fuqi për Arsimin e Lartë. Pranë departamenteve ofrohet informacioni për programet e lëndëve në formën fizike dhe elektronike si edhe në platformën Teams apo Google site, dhe One drive ku studenti ka akses duke u njohur me programin dhe syllabuset për secilën nga modulet dhe lëndët që frekuenton. Burimi: Aneks 2.2, Syllabuset e lëndëve Aneksi 1.3 Plani mesimor Aneksi 2.2.1 Komunikim Syllabusi tek studentët Aneksi 2.17 Njoftim i studentëve për aksesin e materialeve.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Në çdo vit akademik, në planin mesimor, pasqyrohen detajet në lidhje me organizimin e këtij programi, si dhe objektivat formuese të tij, bazuar në rregulloren didaktike dhe rregulloren e programit të studimit, të miratuara nga departamenti, dekanati dhe senati akademik i UNYT. GVJ konstaton se lëndet rishikohen, përditësohen dhe miratohen para fillimit të çdo viti akademik, për të siguruar një përmbajtje të përditësuar. Vlerësohet fakti se duke ndjekur zhvillimet dhe tendencat aktuale në fushën e arkitekturës, synohet që programi të përshtatet me kërkesat e ndryshme të tregut të punës. Burimi: Aneksi 4, Syllabuset Aneksi Strategjia e programit			
Konkluzione	<i>Gjatë vizitës në institucion është vërejtur përkushtimi maksimal, duke punuar vit pas viti, i stafit akademik të rregullt dhe atij administrativ, për përmbushjen e misionit dhe objektivave për këtë program studimi të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Arkitekturë", në mënyrë që ky program të jetë i strukturuar, informues, dhe i organizuar mirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për	Gjatë vizitës në Institucion, për Programin Master i Shkencave në Arkitekturë - UNYT, GVJ konsultoi se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave dhe emërtimi, janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga korniza Shqiptare dhe ajo evropiane e kualifikimit. Informacioni për mundësitë për punësim pas diplomimit, në			

studime të mëtjshme dhe/ ose punësimin e studentëve.	përfundim të këtyre studimeve, u ofrohet studentëve në formën e shërbimit të këshillimit të karrierës, si një përjasje në të mirë të studentëve me tregun e punës, duke i mbështetur dhe inkurajuar në zhvillimin e plotë të potencialit të tyre, për një rol domethënës në shoqëri. Aftësitë dhe njohuritë e marra nga ky program i nivelit të dytë, mundësojnë studentët të aplikojnë në praktikë për punësim si në tregun privat ashtu edhe në administratën publike. Programi ndjek një progression logjik cdo vit, me një game të gjerë temash, duke nisur nga teknologjia, konstruksioni dhe materialet, paraqitja grafike dhe teknikat e projekteve, njohuri mbi teorinë e artit dhe arkitekturën, dizajnin urban si dhe planifikimin urban. Kontaktet e UNYT me zyrën e Karrierës dhe Alumni me komunitetet e biznesit në Shqipëri e Rajon, kanë qëllim të ofrojnë praktika dhe mundësi punësimi për studentët e UNYT. Burimi: Aneksi 1.7/1.9 Rregullore e UNYT, Rregullore e Departamentit Aneksi 2.1 Tabela përmbledhëse
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	Bazuar në dokumentacionin e depozituar, kryesisht në Rregulloren e programit të studimit, Planin mësimor e silabuset, GVJ vlerëson se struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit. Programi i studimit në Arkitekturë është i strukturuar në pesë vite akademike të ndara në 10 semestra, ku secili përfshin lënde teorike, praktike dhe projektuale, me një shpërndarje graduale të njohurive dhe aftësive nga bazat drejt nivelit të avancuar. Burimi: Aneksi 1.7/1.8 Rregullore e Universitetit, e Fakultetit Aneksi 2.4 Strategjia e programit të studimit Aneks 1.3 Plani mësimor
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Gjatë vizitës në IAL, vihet re se ky program ka arritur më së miri të përcjellë tek studentët formimin profesional të duhur, duke i mundësuar atyre me sukses transferimin e studimeve kur ka qenë e nevojshme, mobilitete në vende të ndryshme (ketu: rekomandohet të ketë një numer me të lartë të mobiliteteve, në kuadër të Erasmus +, tek studentët), si dhe më e rëndësishmja punësimin e tyre në përfundim të studimeve, me këshillime konkrete lidhur me tregun e punës, dhe kontaktet me punëdhënësit potencial. Raporti i orëve midis teorisë dhe praktikës, ndryshon sipas lëndëve në këtë program. Ekspertizë dhe modele suksesi nga universitete partnere, industria e ndërtimit dhe projektimit në lidhje me nevojat specifike të kësaj industrie, dhe eksperiencat e shkollave evropiane dhe më gjerë, janë konsideruar nga UNYT, me qëllim ngritjen dhe vazhdimësinë e programit. Burimi: Aneksi 1.7/1.8 Rregullore e Universitetit dhe Fakultetit Aneksi 2.4 Strategjia e programit të studimit Aneks 1.3 Plani mësimor
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen	GVJ gjykon se raportet midis formimit 14 % lëndë teorike dhe 50 % lëndë profesionale-praktike, të cilat ndryshojnë sipas disiplinave, plotësojnë standartet akademike. Personeli akademik është i ngarkuar me përgjegjësi

e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	për arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitete apo edhe punësim, si hallka e fundit në kurorëzim të studimeve. Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit nxit studentët të marrin pjesë në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, aktivitete të cilat synojnë të ndihmojnë studentët të marrin një përvojë në fushën e arkitekturës si dhe përmbushjen e objektivave formuese të programit. Praktikat në institucionet publike apo mobilitete në kuadër të projekteve ndërkombëtare janë mundësi e jashtëzakonshme. <i>Rekomandohen të rritet numri i mobiliteteve, shkëmbimit të studentëve në programin e Arkitekturës, në vitet në vijim.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ konstatoi që drejtuesi i departamentit koordinon dhe jep të gjitha informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve, përfshirë informacionet e nevojshme për lëndët, për ngarkesën mësimore, frekuentimin e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, materialet mësimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemin e vlerësimit etj. Këto materiale u vihen në dispozicion studentëve nga vetë pedagogët. Syllabuset e detajuara për çdo lëndë janë gjithashtu të publikuara në arkivin elektronik të shkollës. Programi i studimit hartohet dhe rishikohet duke konsideruar, zhvillimet më të fundit shkencore në fushën e planifikimit mjedisor, sfidave të zhvillimit urban, kërkesat e tregut dhe dinamika e fenomeneve globale kercënuese për shëndetin njerëzor e mjedisor në funksion të reziliencës dhe qëndrueshmërisë mjedisore dhe menaxhimit dhe përshtatjes të fenomeneve.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Gjatë vizitës në institucion, në bisedën e organizuar me studentë, si dhe bazuar në dokumentacionin e depozituar, kryesisht në përmbajtjen e programit të studimit, GVJ vlerëson se struktura e programit, është në përputhje me profilin e programit. Ai garanton aftësimin, thithjen e njohurive dhe marrjen e kompetencave në fushën e arkitekturës, që përfshin njohuri teorike dhe praktike. Këto fusha dhe aftësi janë thelbësore për një arkitekt dhe i pajisin studentët me njohuritë dhe eksperiencën e nevojshme për të krijuar projekte që janë funksional, të qëndrueshëm dhe artistikisht tërheqës. Burimi: Aneksi 1.3 Plani mesimor
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Kombinimi i dijes me punën e pavarur të studentit në kërkim shkencor nëpërmjet projekteve dhe detyrave, si dhe rastet studimore të trajtuara nga modulet dhe lëndët, kryesisht kanë në fokus territorin shqiptar, ku edhe gjendet tregu më i madh i punës. Në raportin e GVB, citohet që: Ndërveprimi me struktura si qeveritare ashtu edhe joqeveritare, mundëson projekte dhe nisma të përbashkëta, duke rritur kështu ndërveprimin e studentëve me tregun e punës. (vihet re se nuk ka të dhëna konkrete në materialet e depozituara). Vlerësohet angazhimi i Departamentit i cili vepron në bashkëpunim me Zyrën e Karrieres dhe partnerë të tjerë të jashtëm për të marrë në konsideratë mendimet, propozimet me qëllim përmirësimin e programit të studimit, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve aktuale.

	Burimi: Aneksi 5.11 Rregullore Zyra e Karrieres			
Konkluzione	GVJ konkludon se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje të plotë me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Lidhur me integrimin e studentëve në tregun e punës, GVJ mësoi se UNYT i ka kushtuar një vëmendje të vecantë këtij procesi. Përveç angazhimit të tyre që vitin e tretë të studimeve, ku intershipi bëhet lëndë e detyrueshme dhe vendos studentët në marrëdhënie bashkëpunimi dhe në projekte që mundësojnë punësim në të ardhmen. Qëllimi kryesor mbetet promovimi i zhvillimit të aftësive të transferueshme dhe nxitja e studentëve për të përmirësuar profesionalizmin dhe aftësitë e tyre në mënyre aktive. Burimi: Aneksi 3.9.2 Lista e Intership-eve
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Çdo vit, studentët e këtij programi përfshihen në Senat, në zyrën e sigurimit të cilësisë, këshillin e etikes, duke iu dhënë mundësinë për të shprehur mendimin e tyre. Nga diskutimi me studentët, vumë re se janë pjesë e rëndësishme e procesit të përmirësimit të programit. Ata janë të përfaqësuar në organet më të larta drejtuese të UNYT, si në senatin akademik, në njësinë e brendshme të sigurimit të cilësisë, si pjesë e vendimmarrjes dhe mundësisë të shprehin mendimin e tyre mbi përmbajtjen dhe menyrën e zhvillimit të lëndëve, kurrikulës së programit. Më tej GVJ mësoi që departamenti merr pjesë aktivisht në seminare dhe leksione të hapura, workshope ku studentet kanë rastin të krijojnë kontakte me sipërmarrës e kompani vendase dhe të huaja. Rekomandohet që përmirësimi periodik të ndodh gjithmonë në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm të tregut të punës. Burimi: Aneks 1.20, Konferenca IC-ASP 2023 Aneks 5.6 Panairi pune dhe studimit
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me	Rezulton se institucioni ka bashkëpunim me partnerë, rrjete dhe organizma të ndryshëm të cilët kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë duke përditësuar universitetin me zhvillimet më të fundit ndërtimore dhe urbane në vend dhe rajon. Burimi: Aneks 42, Institucionet dhe organizatat në bashkëpunim në nivel institucional

rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.			
Konkluzione	Kujdesi i institucionit për informimin e studentëve mbi kërkesat e tregut dhe ndihma e ndërmjetësimi për punësimin ka dhënë rezultate të prekshme. Studentët janë të përfshirë dhe të informuar për ofertën akademike, mundësitë për punësim pas diplomimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ pasi u njoh me dokumentacionin e depozituar si dhe gjatë vizitës në institucion, u informua se në fillim të cdo viti akademik, hartohet një raport që pasqyron realizimin e projekteve kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombetare në të cilat përfshihet personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. Universiteti synon të pajisë studentët me cilësitë e lidërshp-it në fushën e Arkitekturës në mënyrë që të ndikojnë për një zhvillim të qëndrueshëm në rajon e më tej. Burimi: Aneks 1.6, Plani Strategjik 2020-2025, 2026-2030
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Në përputhje me statutin, të UNYT dhe rregulloren e përgjithshme, vihet re se stafi vepron në liri të plotë dhe të pavarur akademike Për të ofruar, cilësinë më të lartë të mësimdhënies dhe rritjen e angazhimit në kërkimin shkencor. Plani vjetor i kërkimit shkencor hartohet cdo vit. Ai diskutohet dhe miratohet në nivel departamenti dhe fakultetit, ku stafi akademik prezanton idetë për projektet e tyre dhe rezultatet e detyrave studimore. Gjithashtu UNYT ka zhvilluar një program kujdesi dhe përkrahje për studentët, duke përfshirë këshillim akademik, bursa studimi dhe shërbime mbështetëse. Burimi: Aneks 1.8, Aneks 3.4, Aneks 49, Aneks 5.7
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, ka gjithë kapacitetin njerëzor, financiarë, infrastrukturor për të kryer një kërkim shkencor, me burimeve të brendshme edhe me kontribute nga projektet e përbashkëta të financuara drejtpërdrejtë. Rekomandohet që axhenda e kërkimit shkencor, të hartohet në fillim të cdo viti akademik, në nivel institucional, me fokus angazhimit të studentëve në projekte dhe aktivitete kërkimore. Burimi: Aneksi 3.29 Projekte, Aneksi 3.24.1
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht	Fakulteti harton planin vjetor të kërkimit shkencor, departamenti i mjedisit planin e departamentit si dhe planin individual të cdo anëtarit të stafit të departamentit. Plani i hartuar monitorohet nga njësia bazë dhe mbështetet financiarisht nga institucioni, në mënyrë sistematike dhe në

nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	fund të vitit akademik, fakulteti, departamenti dhe cdo anëtar i stafit dorëzon tabularin e realizimit të planit të kërkimit shkencor. UNYT mbështet financiarisht për të realizuar aktivitete shkencore, kërkimore e studimore. Departamenti mbështet stafin për botime shkencore, aktivitete kërkimore, konferenca etj, në shërbim të studenteve. Burimi: Aneks 3.22 Plan Buxheti			
Konkluzione	UNYT ka politika të qarta lidhur me kërkimin shkencor, në të cilën mbështetet edhe aktiviteti shkencor i programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore- shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Referuar vizitës në IAL si dhe dokumentacionit të depozituar, u konstatua se Personeli Akademik (Stafi akademik dhe ai kërkimor) i këtij program studimi përmes angazhimit të tij në kërkimin shkencor dhe publikimeve, jep kontribut të vazhdueshëm në zhvillimin e shkencës dhe sektorëve të prodhimit dhe shërbimit në fushat që lidhen me to. IAL ka bashkëpunim me struktura kërkimore e shkencore sic janë universitet, qendrat kërkimore, kompanitë e ndërtimit, dhe njësite vendore. Në këtë mënyrë, rekomandohet që programi të arrijë të ofrojë një mjedis stimulus për zhvillimin e aftësive dhe njohurive në fushën e arkitekturës dhe kërkimit shkencorë. Burimi: Aneksi 1.2 Misioni dhe objektivat Aneksi 2.4 Strategjia e zhvillimit të programit
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti ofron aktivitete me natyrë shkencore dhe angazhon personelin akademik, në funksion të realizimit të objektivave të këtij programi studimi, dhe forcimit të mendimit kritik. <i>Rekomandohen aktivitete shkencore, që përfshijnë botime, pjesëmarrje në konferenca, prezantime, udhëheqje të studenteve master, doktorante etj.</i> Burimi: Aneks 2.18 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2018-2022
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	GVJ kostaton se Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit inkurajon rritjen e kualifikimit të stafit në kuadër të kërkimit shkencor duke ofruar mundësi për mobilitete dhe mbështetje financiare. <i>Rekomandohet që IAL duhet të marrë masa konkrete për rritjen dhe motivimin e stafit të saj për të qenë më aktiv në konferenca shkencore, simpoziume, botime etj.</i> Organizimi i konferencave apo aktiviteteve shkencore nga vetë IAL, mund të shërbente si një motor rigjenerues për stafin akademik.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë	Nga njohja me dokumentacionin vëmë re se syllabusët e këtij programi studimi janë treguesi i asaj që një student pritet të dijë, kuptojë dhe të jetë në gjendje të demostrojë pas përfundimit të një përvoje mësimore. Për

konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	rrjedhojë, studenti duhet të jetë kompetent dhe i aftë për të përdorur rezultatet e të nxënës në situata pune ose studimi. Kurrikulat e avancuara, Integrimi teknologjive të reja, ndërkombëtarizimi, lidhjet e forta me industrinë dhe infrastruktura moderne, e mbështetje për kërkimin shkencor duhet të jenë komponente të cilët mbështesin të diplomuarit, edhe japin një vision global dhe etike profesionale.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	GVJ konstaton se program i studimit është në përputhje me të gjitha rregulloret në fuqi dhe krijon themelet për kualifikimin profesional dhe marrjen e licenses si arkitekt, i aftë për tregun vendas dhe të huaj. Burimi: Aneksi 2.4 Strategjia e zhvillimit të Programit			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	GVJ konstaton se program i studimit është në përputhje me aktet ligjore në vend, për licensimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim, dhe mbikëqyrje, e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim.			
Konkluzione	<i>Institucioni nëpërmjet ndërkombëtarizimit, si dhe pjesëmarrjes në aktivitete si simpoziume, workshope, konferenca e kongrese mund të ofrojë një platformë të qartë, të realizueshme dhe të thellë të këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ, gjatë vizitës në Institucion dhe nga materialet e depozituara, gjeti të dhëna se: Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit mban gjithmonë në fokus cilësinë e programit të studimit, duke ofruar forma mësimdhënie sa më efektive, me qëllim aftësimin e studentit me njohuritë e kërkuara nga tregu i punës. GVJ u interesua posaçërisht për aktivitetin mësimor të studentëve dhe u njoh me të dy metodat: metodat direkte: leksione, seminare, leksione të hapura, praktika laboratorike, vizita dhe inspektime në terren, punë në grup; metodat e bazuar në problem: ekspozita, panaire, referime projektesh. Disa forma të tjera vijnë përmes workshopeve të organizuara gjatë vitit akademik, (Aneksi 1.13 Workshope 2020-2025) ku pjesëmarrës janë studentët e Arkitekturës. Burimi: Aneksi 1.12. Evente Leksione të hapura Aneksi 2.2 Syllabuset, intership Aneksi 1.3 Plani mesimor Aneksi Pjesëmarrja e studenteve në konkurse
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Përmes angazhimit të tij, personeli akademik në thelb të punës ka respektimin dhe nevojat e studentëve. Disa metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, nga GVJ konstatoi se UNYT u përgjigjet nevojave fizike dhe psikologjike të studentëve, përmes qendrës së këshillimit dhe mbështetjes akademike. Në IAL ndihej një mjedis besimi dhe rritjeje individuale të studentit. Burimi: Aneksi 3.2 Qendra e Mbështetjes Akademike dhe Qendrës së Këshillimit Aneksi 3.4 Lista e Këshilltarëve Akademike
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Gjatë vizitës në institucion është vërejtur përkushtimi maksimal i stafit akademik të rregullt për përmbushjen dhe përmirësimin e kompetencave didaktike për këtë program studimi. Institucioni nga ana tjetër mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike me një shumëllojshmëri mënyrash dhe instrumentash. UNYT mundëson trajnimin e vazhduar të personelit akademik nëpërmjet aktiviteteve, konferencave, seminareve, workshopeve të brendshme që organizohen si dhe inkurajon pjesëmarrjen në programe mobiliteti si Erasmus + dhe Mevlana. Institucioni ofron edhe mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit në aktivitete shkencore. <i>Rekomandohet gjithëpërfshirja e stafit të departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit që të thellojnë kompetencat didaktike nëpërmjet aktivizimit në projekte evropiane, si ERASMUS+, Horizont 2020, ku trajnohen në një ambient ndërkombëtar, ku shkëmbehet njohuri dhe eksperiencat didaktike e shkencore.</i> Burimi: Aneksi 1.28 Shkëmbimi i stafit akademik statistika

	Aneksi 1.19 Lista e MOU MEVLANA, ERASMUS + Aneksi 3.7.1 Mbështetje financiare për kërkim shkencor
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Gjatë intervistave me studentet e këtij program u vërtetua se puna e mësimdhënësve me studentë në rastet e punimit të diplomave master, janë dëshmi e rritjes së efikasitetit të nxënies. Marrëdhëniet dhe etika e komunikimit midis stafit dhe studentëve është një faktor i nxitjes së studentit, që të jetë aktiv e pjesëmarrës në diskutimin në auditor e jashtë tij, në shfaqjen e ideve dhe mendimit profesional.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ vëren se IAL, e organizon aktivitetin e monitorimit në nivel institucional nëpërmjet Njesisë së brendshme të sigurimit të cilësisë, NJBSC, e cila operon në nivel universiteti dhe drejton të gjithë procesin e vazhdueshëm të vetëvlerësimit, raportimit të rezultateve, ndjekjes së reagimit ndaj tyre me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. U konstatua që hartohen raporte vetë-vlerësimi i anëtarëve të departamentit, vlerësime nga studentet, nga koleget (peer evaluation) dhe nga drejtuesit, nxirren rekomandime, si dhe propozohen masa për ndryshime apo korrigjime për raste apo çështje konkrete. Nga intervitat mësuam se UNYT kryen në mënyrë periodike vlerësimin e pedagogëve dhe të formave e metodave të mësimdhënies, ku përdoren metoda të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, ndjekja e ecures së studentëve, opinioni i tyre etj. Ky proces përfshin vlerësimin nga ana e studentëve, të vlerësimit të stafit, vlerësimin nga të barabartët (kolegët, vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga eprori. Burimi: Aneksi 6.6 Formular për Raportin Vjetor të Monitorimit
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik	GVJ bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe në vizitën në IAL, konstaton se Universiteti ka ngritur strukturën për vlerësimin e kërkimit, me qëllim ngritjen e një sistemi pikëzimi të brendshëm, që ka qëllim nxitjen dhe motivimin e stafit për të zhvilluar kërkim shkencor cilësor, përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Komisioni i Përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë është një strukturë autonome, me përfaqësues nga të gjitha fakultetet dhe një student. Kjo strukturë monitoron procedurat për vlerësimin e njësive akademike, konform kuadrit ligjor. Nga studentët u mësu se ata në mënyrë specifike japin vlerësimin e tyre mbi metodat e përdorura në klasë dhe mbi efektshmërinë e tyre. Vlerësimi i studentëve është anonim, mbi bazën e një pyetësori të strukturuar. Rezultatet e përfituara nga pyetësori i behen të ditur stafit, studentëve, administratës dhe më gjere. Të dhënat bëhen pjesë e Raportit Vjetor që institucioni dërgon në

për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	MASR dhe ASCAL. UNYT organizon seminare të hapura, seanca trajnimi dhe ve në dispozicion dokumente në ndihmë të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Duke patur parasysh karakterin aplikativ dhe zhvillimin e vazhdueshëm të profesionit, institucioni është i angazhuar të nxisi përdorimin e komponentëve inovativë në metodat e mësimdhënies të bazuar në praktikat në të mira ndërkombëtare. Burimi: 1.15.5 Raporti vjetor i monitorimit Aneksi 6.6 Raport vjetor NJSBC Aneksi 6.9.2 Vlerësimet e pedagogëve nga studentët			
Konkluzione	UNYT ka pjesë të strategjisve të tij për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si komponent bazë për konsolidimin e institucionit. Vërehet se institucioni ka një fokus të mirëpërcaktuar dhe garanton sigurimin e cilësisë për programin që ofron.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ u njoh me Rregulloren e UNYT, për më tej u interesua posaçërisht për mënyren e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore në këtë program studimi, Master i Shkencave të integruar në Arkitekturë, në Rregulloren e Departamentit, seksioni D, dhe procedurat e provimeve ku jepen detajet në lidhje me metodat e vlerësimit të studentëve, provimeve detyrave të kursit, projekteve prezantimeve dhe pjesëmarrja në klasë. Referuar Aneksit 1.10, të Rregullores së Programit të Studimit, rezultojnë se: Testimi i njohurive të marra gjatë semestrit dhe pesha specifike e tij në vlerësimin përfundimtar deklarohet nga pedagogu në fillim të çdo lënde në syllabusin e modulit dhe ecuria i komunikohet po në mënyrë të vazhdueshme studentëve. - në fillim të çdo semestri, pedagogu i paraqet klasës planin mësimor, i cili përfshin formularët e vlerësimit dhe ndarjen javore të temave, detyrave, studimit, punës në terren. (40% provimi përfundimtar, 30% provimi i ndërmjetëm, 20% detyrë kursi, 10% pjesëmarrje aktive). Testimi dhe vlerësimi i studentit bëhet në formë të shumëllojshme, kjo në varësi të lëndës dhe specifikimeve që kjo lëndë mbart.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Gjatë intervistave me studentet u vu re se ata, informohen në disa mënyra: - në fillim të secilës lënde atyre u vihet në dispozicion programi i lëndës nga pedagogu i lëndës, me elementet informues për javët,

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	metodologjine e vlerësimit të njohurive apo edhe praktiken profesionale nese ka. -aksesi që studentët kanë në llogarinë e tyre personale, nëpërmjet postes elektronike dhe website të lëndes në platformën Teams apo Google site. Burimi: Rregullore e Programit Master i Shkencave i Integruar në Arkitekturë, Neni 20 dhe 21; Plan program (syllabus)			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në dokumentacionin e depozituar, kryesisht në Rregulloren e programit të studimit, neni 32, Planin mësimor e silabuset, GVJ vlerëson se Përmbajtja e programeve mundeson që studentit të demonstrojë lehtësisht njohuritë dhe kompetencat e fituara. Nga GVJ u konstatua se vlerësimi i studentit realizohet në mënyra të ndryshme, në varesi të lëndës dhe specifika të saj. Gjatë vitit, vlerësimi ndahet në disa komponente, me qëllim sigurimin e një ndërthurjeje të punës së pavarur praktike kërkimore e teorike. U mësua se studentet vlerësohen për frekuentimin e pjesëmarrjes në mësim, angazhimi në detyra kursi, eseve, detyra laboratorike, prezantime, studio, praktika në terren, teste të ndërmjetme e provimi final. Burimi: Aneks 2.2 Syllabuset e programit Aneks 1.10 Programi MSc Arkitekturë			
Konkluzione	<i>Ndërgjegjësimi i stafit të UNYT mbi sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe në vlerësimin e studentit lidhet drejtpërdrejtë me vizionin e institucionit, me synimin për tu dalluar si një institucion që ofron shërbime cilësore për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	Në diskutimet e bëra me grupin e studentëve në Institucion u vu re se mënyrat e testimit e të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Departamentit të Arkitektures dhe Dizajnit (Aneksi 1.9, neni 32) dhe më pas detajohen në rregulloren didaktike dhe atë të programit të studimit, të cilat janë publike dhe të aksesueshme nga studentët. Punimet me të mira të studentëve ruhen në kopje fizike për përdorim të ekspozites së fundvitit, si dhe punimet më të mira dixhitale arkivohen si referenca për punën kërkimore. Vihet re se UNYT i ka kushtur një vëmendje të veçantë dhe sistemit elektronik të ruajtjes së shënimeve të studentëve i cili është i qëndrueshëm dhe shumëfunksional.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të	GVJ vlerëson se UNYT duke njohur rëndësinë e shmangies së kopjimit të plagjaturës, përdor prej disa vitesh sistemin elektronik anti plagjaturë

testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	(turnitin.com). Turnitin e lehtëson pedagogun në identifikimin e rasteve të kopjimit të detyrave, duke e bere të pamundur kopjimin e modeleve të përdorura me parë, me qëllim ruajtjen e origjinalitetit dhe rrisjen transparencës. Pedagogu i lëndës apo modulit gëzon të drejtën e plotë të organizojë vlerësimin e lëndës, duke zbatuar parimet e rregullores universitare dhe kërkesave të lëndës. Në këtë formë vlerësimi mund të ndahet në disa komponentë përgjatë vitit, provime periodike, seanca debate apo punë në laborator, punë në grup, prezantime, angazhime etj. Dorëzimet e detyrave të ndërmjetme dhe përfundimtare të studentëve kryhen fizikisht dhe elektronikisht. Kujdesi për vlerësimet periodike të studentëve nga mësimdhënësit, organizimi i testeve, mënyra e mbajtjes së tyre, vlerësohet se është brenda standardeve akademike dhe nuk mund të ketë abuzim.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, në Rregulloren e Përgjithshme, vumë re se vlerësimi përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës), të ngritura nga departamentet dhe të miratuara nga dekani i fakultetit, sic parashikohet nga rregullorja e përgjithshme e institucionit. Në fund të cdo provimi, pedagogu organizon seanca konsultimi ku njoftohet vlerësimi, dhe komentete nevojshëm. Ai plotëson procesverbalin e notave “grade roster” konform skemes së silabusit. Përputhshmëria me silabusin kontrollohet nga njësia baze, departamenti, nëpërmjet procesit të transparencës dhe vlerësimit që kryhet në fund të cdo semestri. Burimi: Aneks 2.2 Syllabuset Aneksi 1.9 Rregullorja e departamentit, neni 32
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë intervistës në IAU, u konstatua se nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, kryesisht gjatë orëve të seminarit, testeve të ndërmjetme apo prezantimeve të detyrave, pedagogu orjenton për performancën e studentit lidhur me përvetësimin e njohurive të fituara. Studentet kanë të drejtë ta kontrollojnë notën e tyre në cdo kohë dhe nga cdo pajisje elektronike nëpërmjet sistemit elektronik KION. Burimi: Aneksi 2.16 Sistemi Kion
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë”, synon paanshmëri dhe drejtësi në vlerësimin e detyra, provimet apo projektet e studenteve, i cili sigurohet nga zinxhiri i mekanizmave që ka ndërtuar institucioni. Detyrat e kursit me tekst verifikohen të gjitha në sistemin online antiplagjiaturë Turnitin (https://www.turnitin.com/), ndërsa në fushën e arkitekturës pedagogoet përdorin platformën google image, për identifikimin e imazheve plagjiature të marra nga internet. Burimi: Aneks 3.17.1 Shembull i përdorimit të sistemit Turnitin Aneksi 3.17 Draft rregullorë AI
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në	Kontrollet e dijeve bazohen në meritë dhe ky fakt, duke patur një rëndësi të vecantë për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor monitorohen dhe ndiqen nga afër nga institucioni.

kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Gjatë pyetjeve që GVJ u beri studentëve, rezultoi se Personeli akademik në procesin e kontrollit të njohurive të studentit është korrekt me rregulloren e universitetit dhe me specifikimet në syllabus, pasi lëndë të ndryshme të programit kanë mënyrë të vecantë kontrolli. Kontrolli i aplikimit të meritokracisë realizohet gjithashtu nëpërmjet procesit të transparencës së notave. Burimi: Aneks 3.16, Komunikimi i notave të provimit Aneks 3.1 Kodi i Etikës, Aneksi 3.8 Raporti i transparencës së notave		
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Mbështetur në Rregulloren e Programit MSc Arkitekture, të UNYT, përcaktohet e drejta e studentit jo vetëm për tu njohur me vlerësimin por edhe për tu informuar më në detaje për mënyrën se si është vlerësuar puna e tij, duke kërkuar rishikim nga ana e komisionit të vlerësimit, dhe më pas në ngjitjen e një komisioni të pavaruar dhe rishqyrtimin e detyrës apo testit. Burimi: Aneks 1.10, Rregullore e Programit Aneksi 3.12 Procedura e provimeve		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar nga materiet e vëna në dispozicion, konstatohet se Studenti në universitetin UNYT ka të drejtë të njihet me vlerësimin, të diskutojë paqartësitë dhe pikat e provimit dhe për pakënaqësi nga procesi, ka të drejtë të drejtohet drejtuesit të departamentit. Nëse studenti pvrseri ka pakenaqësi me vendimin e drejtuesit të departamentit, atëherë ka të drejtë të kërkojë rivlerësim nga komisioni i peticioneve, organ i vendosur me vendim të senatit akademik. Vlerësimi i komisionit të posaçëm i ndiqet nga Zyra e Cështjeve studentore. Më pas i gjithë procesi dokumentohet dhe vlerësimi arkivohet. Burimi: Aneksi 3.12 Procedura e Provimeve		
Konkluzione	<i>Institucioni synon vlerat maksimale, përmes një vlerësimi të drejtë, transparent dhe të merituar. Studentet janë fokusi parësor i UNYT.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Vlerat dhe cilësitë e Programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë”, reflektojnë direkt tek studentët, duke plotësuar spektrin e gjerë e të thellë të njohurive, aftësive profesionale dhe aftësive të vecanta të studentëve, konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar. Natyra e lëndëve dhe moduleve mbulon çështjet teorike; mbulon çështjet e karakterit teknik profesional e aplikativ; mbulon aspektet sociale e kulturore të profesionit si dhe nëpërmjet lëndëve të vecanta, zhvillon te studentët aftësinë praktike.

	GVJ verën se program i studimit synon që studentët të pajisen me njohuri profesionale nëpërmjet lëndëve si dizajni arkitekturor, design studio apo planifikim urban. Departamenti ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar ekspedita dhe internshipe për studentët. Programet Erasmus, i japin mundësi studentëve me rezultate të larta të aplikojnë për mundësi shkëmbimi me universitetet partnere. Burimi: Aneksi 1.3 Plan i mesimor Aneksi 2.2 Syllabuset
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Duke mbajtur në konsideratë zhvillimet e fundit ndërkombëtare, Teknologjia e informacionit konsiderohet si një nga forcat shtytëse më të rëndësishme në transformimin e profesionit. Duke qenë se arkitektura është një nga fushat prioritare në vend, aktivitete të ndryshme edhe jashtë universitetit kanë mundësuar një hapësirë të madhe ndërveprimi për studentët me ekspertë të fushës shqiptare dhe të huaj. GVJ vlerëson se kurrikula është hartuar që studentët e Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit të përfitojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre edhe në lëndë preferenciale të lidhura me shkencat kompjuterike, Instrumentat laboratorikë i japin studentit mundësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe aplikimin më tej të dijeve teorike në praktikë. Burimi: Aneksi 1.3 Plan i mesimor Aneksi 2.1 Tabelat Permbledhese
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Bazuar në dokumentacionin e depozituar, si plani mësimor, rregullore e programit të studimit si dhe silabuset e lëndëve, GVJ vlerëson se programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Konkretisht kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti analizohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik orientojnë dhe mbështet studentet në zbatimin e detyrimeve përmbyllëse. Burimi: Aneksi 1.15.5 Raporti vjetor i monitorimit DAD 2023-2024
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies	GVJ konkludon se nëpërmjet mësimdhënies synohen vlerat maksimale të të nxëniet të studentit. Vlerat dhe cilësitë e mësimdhënies reflektohen direkt tek studenti, në performancën e tij si dhe arritja e rezultateve nxënëse që plotëson objektivin e institucionit. Rezulton se studentët e disiplinave të ndryshme si arkitekture, Dizajn interieri, bashkëpunojnë me njeri tjetrin, duke zhvilluar njohuritë e marra në laboratore dhe praktika profesionale. (psh, konkurse ose aktivitete të ndryshme). Mësimdhënësve ju mundësohet që të përgatiten dhe të marrin informacionet më të reja të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, kjo ndihmë ju ofrohet përmes punës ndëraktive të personelit akademik të institucionit. Institucioni që të zhvillojë si aftësitë profesionale në një fushë që është në zhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm, ashtu edhe aftësitë shkencore të të bërit kërkim inovativ personeli akademik krijon një klimë nxitëse të ideve inovative dhe të kërkimeve të avancuara shkencore. Studentët janë gjithmonë të ekspozuar ndaj arritjeve më në

me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	zë në fushën e profesionit ashtu si edhe në kërkimet më inovative në fushën e kërkimit shkencor. Pra personeli akademik, duke qenë i ekspozuar vazhdimisht ndaj një ambjenti konkurrues dhe inovativ është i trajnuar dhe i hapur për të krijuar klimën e përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe për të zhvilluar kërkime të avancuara. Burimi: Aneksi 1.3 Plani mesimor Aneksi 2.2 Syllabuset			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/ jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, vihet re se në IAL zhvillohen leksione të hapura mbi zhvillimet në fusha si: Historia e Artit dhe Arkitekturës, projektimi arkitektonik, interior dizajn, teknologjitë dixhitale dhe trashgimia kulturore nga staf akademik efektiv dhe me kontrate. Këto raste shfrytëzohen si momente ku pedagogët prezantojnë edhe punët e tyre dhe zhvillimit më të fundit të fushës në prezantimet e tyre në konferenca e forume. Vlen të përmendet fakti se maturanteve të shkollave të mesme i janë ofruar një sere leksionesh online falas, nga pedagogje të departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit me tematika si modelimi, metodat e kompozimit, etj Burimi: Aneks 3.19. Shtyllat e kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor 2023-2027 Aneksi 3.19 Kërkimi Shkencor në DAD			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në përputhje me objektivat strategjike institucionale, GVJ konfirmon se Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, mbështet krijimin e hapësirave innovative (Markerspace), integrimin e teknologjive bashkëkohore në procesin e të mësuarit dhe kërkimit, përfshirë inteligjencën artificiale, dizajnin kompjuterik dhe teknologjitë AR/VR, të cilat përgatisin studentët për praktiken arkitekturore të së ardhmes. Mbështetja profesionale dhe mundësitë e financimit, nxisin inovacionin dhe idetë e avancuara të studentëve për pjesëmarrje të gjerë në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare. Burimi: Aneks 2.4 Strategjia e zhvillimit të programit Aneksi 1.6.1 Plani strategjik 2026-2030			
Konkluzione	IAL synon rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët, nëpërmjet thellimit të kompetencave profesionale dhe shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Nga materialet e depozituara konstatohet se në rregulloren e UNYT, Neni 28 dhe 29, ka të miratuar një seksion të veçantë për procesin e diplomimit, (Tezës së Diplomes), e cila rregullon të gjitha aspektet procedurale dhe organizative për detyrimet përfundimtare të studentëve

realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	në këtë program studimi. Kjo rregullore përcakton në mënyrë të detajuar hapat, afatet dhe modalitetet e realizimit të diploma për studentët në mënyrë të hapur dhe transparente. Në këtë rregullore përcaktohet që çdo student pa përfunduar Praktiken profesionale nuk mund të rregjistrohet në diplomë. Projekti i diplomimi është i detyrueshem dhe ai figuron si leëndë e rregullt. Në rregullore rezultojnë për të hyrë në projektin e diplomimit student duhet të marri minimumin e krediteve. Dokumentacioni i dorëzuar nga studentët shqyrtohet nga një komision i përbërë nga tre anëtarë (Kjo strukturë siguron që procesi të jetë i standardizuar dhe i mbikëqyrur). Burimi Aneksi 2.11 Rregullore e projektit të diplomimit
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Studentët mbështeten në mënyrë të vazhdueshme nga departamenti dhe stafi akademik, si dhe nga këshilluesi Akademik përgjatë të gjithë procesit të përgatitjes dhe realizimit të diplomës. Ata pajisen me të gjitha informacionet dhe materialet e nevojshme për hartimin dhe mbrojtjen e diplomës, përmes konsultave të rregullta me pedagogët përgjegjës. Këshilltarët akademik (advisor), koordinatorët e projektit të diplomimit, këshilltarët dhe Përgjegjësi i Departamentit, ofrojnë takime dyjavore për progresin, udhëzime dhe konsulta të qarta mbi kontrollin e plagjiatures, stilin e citimeve dhe formatin e dorezimit. Kjo mbështetje përforcon cilësinë e punës së diplomës dhe siguron orientimin e duhur drejt kërkimit shkencor. Burimi: Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomes
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i diplomimit vlerëson punimin final të studentit si një reflektim të përmblodhur të të gjitha njohurive të fituara gjatë programit. Teza e diplomës është një punim kërkimor që duhet të përfshijë kompetencat e zhvilluara në çdo modul apo lëndë, sipas peshës dhe rëndësisë së tyre në programin e studimit. Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni ad hoc përbëhet nga 5-7 anëtarë dhe merr parasysh: • Aftësitë dhe njohuritë e fituara gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha modulet dhe lëndët përkatëse. • Përmbajtjen shkencore dhe strukturën metodologjike të temës; • Origjinalitetin, cilësinë e kërkimit, zbatimin e projektit; • Cilësinë e argumentimit dhe burimeve të përdorura; • Aftësitë e studentit për të prezantuar dhe mbrojtur tezën përpara një paneli vlerësues. Butimi: Aneksi 5 Skema e vlerësimit të KVT në manualin e temës së diplomës Aneksi 2.11 Rregullore e projektit të diplomimit
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston	GVJ konstaton në Nenin 15 të Rregullores së Programit, se procesi i përzgjedhjes së temës së diplomës është specifik dhe ndërveprues. Studentët nxiten që propozimi i parë mbi temën e diplomës të vijë prej tyre. Në varësi të temave të zgjedhura studimore, studentit i caktohet një këshilluesi i diplomës, i cili e konsulton dhe ndihmon gjatë gjithë

studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	procesit të përgatitjes së diplomës. GVJ vëren se mënyra e përzgjedhjes së temës së diplomës është e strukturuar, por njëkohësisht edhe ndërvepruese. Këshilluesi akademik mund të jete i ndryshëm nga mikeqyesi i temës, i cili përcaktohet si supervisor i projektit të diplomimit në Manualin e Temës së Diplomes. Supervizori i projektit të diplomimit asiston në përgatitjen dhe përpunimin e rezultateve përkatese dhe në hartimin e temës përfundimtare. Ai siguron cilësinë e rezultateve dhe jep miratimin ose jo nëse tema konsiderohet e përfunduar dhe gati për tu mbrojtur. Procesi nis me nxitjen e studentëve që të propozojnë vetë fillimisht idetë për temën e diplomës. Më pas, në varësi të përmbajtjes së temës së zgjedhur, studentit i caktohet një udhëheqës akademik që e mbështet dhe e këshillon gjatë gjithë periudhës së përgatitjes së diplomës. Gjatë takimeve midis studentit dhe udhëheqësit, zhvillohen diskutime që ndihmojnë në orientimin drejt një teme të përshtatshme dhe të qëndrueshme për mbrojtje. Ky proces krijon një hapësirë që stimulon iniciativën individuale dhe kreativitetin e studentit, ndërkohë që siguron mbështetje akademike për strukturimin shkencor dhe metodologjik të punimit. Burimi Aneksi 2.11 Rregullore e projektit të diplomimit, Manuali
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ gjatë vizitës konstatoi se institucioni mbështet studentët në zhvillimin e punëve praktike nepermjet asistences për vizita në terren dhe aksesimit në buriemt e universiteti si software dhe pajisje kaboratore modelimi, dhe testeve laboratorike, të cilat realizohen me mbështetjen e plotë të infrastrukturës fizike (laboratorëve dhe ambienteve ndihmëse) dhe asaj dixhitale. Vihet re se të gjitha mjediset e UNYT, janë në shërbim të studentëve së bashku me administratën, personelin akademik dhe ndihmës. Kjo mbështetje është thelbësore për studentët, pasi u mundëson atyre të aplikojnë njohuritë e fituara teorikisht në kushte reale dhe të përfshihen drejtpërdrejtë në proceset e kërkimit dhe të zgjidhjes së problemeve në menaxhimin e mjedisit urban. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm ju bë me dije se Institucioni bashkëpunon me partnerë të ndryshëm, për të zhvilluar projekte me tema më të specializuara, me partnere te jashtem, ku mundësohet që edhe studentët të realizojnë temat dhe kërkesat e studimit. Ky bashkëpunim i mundëson studentëve të fitojnë eksperiencë praktike në terren, duke i përgatitur ata për sfidat profesionale ne fushen e arkitektures dhe dizajnit. Burimi: Aneksi 2.11 Rregullore e projektit të diplomës
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Pasi udhëheqësi i diplomës ka shqyrtuar cilësinë e punës së studentit dhe ka marrë rezultatin nga kontrolli antiplagjiaturë përmes sistemit Turnitin, ai vendos nëse punimi është i përshtatshëm për t'u paraqitur përpara komisionit të mbrojtjes. Në rast se vlerësimi është pozitiv, udhëheqësi përcakton vijueshmerine e prezantimit. Në finalizim të mbrojtjes së temës, nota përfundimtare del si mesatarja e pikëve të dhëna nga të gjithë anëtarët e TEC (Manuali i Temës, shtojca 5) dhe shpallet publikisht pas mbrojtjes. E gjithë procedura e vlerësimit realizohet në mënyrë të strukturuar dhe punimi përfundimisht notësohet. Vlerësimi përbëhet nga disa

	komponentë: origjinaliteti, kërkimi, dizajni, hulumtimi shkencorë. Nota përfundimtare i komunikohet studentit nga kryetari i komisionit, në prani të të gjithë anëtarëve. Burimi: Aneksi 1.10 Rregullore e Programit MSc Arkitekture 204 Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomimit			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ konstaton se Referuar Rregullores së Programit, Neni 5, në fund të Programit të Studimit Master i Shkencave i Integruar në "Arkitekturë", studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, lëshohet diploma me emërtimin: "Integrated Master of Science in Architecture" Burimi: Aneksi 3.11; Ankes 3.11.1 Aneksi 2.12 Manuali i projektit të diplomës			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UNYT disponon një sistem arkivimi nga Sekretaria mësimore e cila mirëmban dhe ruan dosjet personale të studenteve. Pas përfundimit të studimeve, të dhënat zhvendosen në Arkivën Qendrore të UNYT, duke ndjekur rregulloren e arkivës. Ndërkohë, të dhënat bazë si numri i matrikullimit, dokumentet e diplomimit dhe dosja personale e studentit ruhen pa afat. Në këtë mënyrë institucioni paraqet në çdo moment informacione për studentin, nëse i kërkohen. Burimi: Aneksi 4.1 Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore. neni 24.25.28			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni ndjek një procedurë të posaçme përmbyllëse të diplomimit të studentit, e cila përputhet me misionin dhe me objektivat për programin e studimit në Master i Shkencave, i Integruar në "Arkitekturë"			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N/A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave	N/A

klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A			
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/ moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	UNYT, përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore, ndjek një procedurë të veçantë për rekrutimin e stafit, të përcaktuar në Aneksin 4.24 “Politikat dhe Procedurat e Departamentit të Burimeve Njerëzore”. Procesi i rekrutimit fillon me shpalljen e vendeve vakante nga Dekani i Fakultetit ose Përgjegjësi i Departamentit, i cili ka përgjegjësinë për të siguruar që kandidati përmbush kërkesat ligjore në fuqi, përfshirë: • kualifikimin akademik, • drejtimin dhe përputhshmërinë me programin e studimit, • mbulimin e moduleve/ lëndëve përkatëse. Në përputhje me Aneksin 4.25, Institucioni zbaton një format standard të procedurës së rekrutimit, që përfshin: • publikimin në databazat e institucionit dhe njoftimin publik për pozicionet vakante; • pranimin dhe vlerësimin e aplikimeve; • shqyrtimin e dokumentacionit të kualifikimit dhe përvojës; • zgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm sipas profilit të kërkuar. Zyra e Burimeve Njerëzore garanton përditësimin në kohë reale të dokumentacionit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme (Aneksi 4.26.1 dhe 4.26.2), dhe ruan një bazë të dhënash për përvojën profesionale dhe angazhimin mësimor të secilit anëtar të stafit. Evidence Aneksi 4.25; 4.25.1; 4.26; 4.26.1; 4.26.2 - Për vitin akademik 2020- 2021 janë angazhuar në mësimdhënie 9 staf akademik prej të cilëve 7 (2 Prof, 2 Dr, 3 Msc) personel akademik efekti (PAE) dhe 2 (1 Prof As, 1 Msc) personel akademik me kontratë (PAK). - Për vitin akademik 2021- 2022 janë angazhuar në mësimdhënie 13 staf akademik prej të cilëve 10 (1 Prof, 6 Dr, 3 Msc) personel akademik efekti (PAE) dhe 3 (1 Prof As, 2 Msc) personel akademik me kontratë (PAK). - Për vitin akademik 2022- 2023 janë angazhuar në mësimdhënie 17 staf akademik prej të cilëve 13 (1 Prof, 10 Dr, 2 Msc) personel akademik efekti (PAE) dhe 4 (1 Prof As, 3 Msc) personel akademik me kontratë (PAK); - Për vitin akademik 2023- 2024 janë angazhuar në mësimdhënie 20 staf akademik prej të cilëve 16 (2 Prof, 1 Prof As, 10 Dr, 3 Msc) personel akademik efekti (PAE) dhe 4 (3 Dr, 1 Msc) personel akademik me kontratë (PAK); - Për vitin akademik 2024- 2025 janë angazhuar në mësimdhënie 25 staf akademik prej të cilëve 18 (2 Prof As, 13 Dr, 3 Msc) personel

	akademik efekti (PAE) dhe 7 (1 Prof As, 2 Dr, 4 Msc) personel akademik me kontratë (PAK). <i>Stafi me MSc normalisht në kushtet kur nuk ka mjaftueshëm Arkitekt me gradë shkencore mund të rekomandohet që stafi me MSC duhet të rregjistrohet në program doktoraturë me qëllim rritjen e cilësisë.</i> Për sa më sipër i jemi referuar Tabelës 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 6.5
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Sipas plani të ngarkesës mësimore dhe realizimit i tyre në vite deri në vitin akademik 2024-2025 rezulton se me shumë se 70% e mbulimit të ngarkesës mësimore realizohet nga stafi efektiv i Universitetit. Në vitin akademik 2024- janë angazhuar në mësimdhënie 25 staf akademik prej të cilëve 18 (2 Prof As, 13 Dr, 3 Msc) personel akademik efekti (PAE) dhe 7 (1 Prof As, 2 Dr, 4 Msc) personel akademik me kontratë (PAK). Bazuar në angazhimin e titullarëve të lëndëve për programin e studimeve të ciklit të parë rezulton se personeli akademik ka titujt e kërkuar nga ligji (VKM nr.41/2018 si edhe udhëzimi nr.29/2018, i ndryshuar.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	UNYT zbaton një politikë të qartë dhe transparente për rekrutimin dhe kontraktimin e stafit akademik dhe ndihmës-akademik, në përputhje me Statutin e Institucionit (Aneksi 1.1.1 – Statuti 2020 dhe Statuti 2025) dhe kuadrin ligjor kombëtar në fuqi. Për nevoja të ndryshme akademike dhe organizative, UNYT përdor tri formate kryesore të kontratave: - Kontratë pune me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar (Aneksi 4.28), - Kontratë pune me kohë të pjesshme (Aneksi 4.28.1), - Kontratë pune me kohë të plotë dhe afat të përcaktuar – përdorur kryesisht për stafin me titull MSc (Aneksi 4.28.2). Në rastet kur stafi akademik mbulon edhe funksione menaxheriale ose administrative, si Përgjegjës Departamenti apo Dekan, kontratat përfshijnë klauzola të veçanta që specifikohen në Aneksin 4.27 – Anekset e Kontratave. Gjithashtu, institucionit i jepet përparësi rekrutimit të stafit akademik të diplomuar në institucione ndërkombëtare, në përputhje me profilin ndërkombëtar të UNYT si një universitet ku mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze. Të gjitha marrëdhëniet e punës janë të rregulluara konform: • Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), • Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, • Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329, datë 12.04.2017, dhe akteve të tjera nënligjore. UNYT siguron gjithashtu mbulim të plotë me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, sipas afateve të përcaktuara nga sistemi tatimor shqiptar. Procesi i përzgjedhjes së stafit ndjek parime konkurruese, meritokratike dhe në përputhje me standardet më të mira të rekrutimit në arsimin e lartë. Bazuar në evidencat sipas Aneksit 4.28; 4.28.1 dhe 4.28.2
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi,	Sigurimi i qëndrueshmërisë së personelit akademik efektiv të angazhuar është një nga detyrat kryesore të UNYT. Personeli akademik efektiv në

mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	këtë program studimi angazhohet prej shumë vitesh në mësimdhënie pranë UNYT. UNYT vlerëson dhe investon në angazhimin të vazhdueshëm të stafit me kohë të plotë duke bërë të mundur rikthimin vit pas viti për të vazhduar me mësimdhënien e lëndëve përkatëse. Kjo marrëdhënie rregullohet me përditësimin e kontratës nga të dyja palët. Për këtë arsye, një pjesë e mësimdhënësve me kohë të pjesshme rikthehen vit pas viti për të vazhduar me mësimdhënien e lëndës përkatëse. Kjo marrëdhënie rregullohet me dakordësinë e të dyja palëve në kontratë. Në rastet kur stafi akademik mbulon edhe funksione menaxheriale ose administrative, si Përgjegjës Departamenti apo Dekan, kontratat përfshijnë klauzola të veçanta që specifikohen në Aneksin 4.27 – Anekset e Kontratave. Gjithashtu, institucionit i jepet përparësi rekrutimit të stafit akademik të diplomuar në institucione ndërkombëtare, në përputhje me profilin ndërkombëtar të UNYT si një universitet ku mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze. Të gjitha marrëdhëniet e punës janë të rregulluara konform: • Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), • Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, • Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329, datë 12.04.2017, dhe akteve të tjera nënligjore. UNYT siguron gjithashtu mbulim të plotë me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, sipas afateve të përcaktuara nga sistemi tatimor shqiptar. Procesi i përzgjedhjes së stafit ndjek parime konkurruese, meritokratike dhe në përputhje me standardet më të mira të rekrutimit në arsimin e lartë. Sipas Aneksit 2.3 janë bashkëlidhur CV e stafit akademik. Rekrutimi i tyre bëhet duke ndjekur procedurat të cilat janë sa transparente po dhe aq ligjore në përzgjedhjen e stafit sipas kërkesave nga drejtuesit e programit për përzgjedhjen e kandidatëve me ekspertizë në kërkimin shkencor dhe të mësimdhënies në lëndët konkrete. Procedura për rekrutimin vijon me identifikimin e nevojës në departament, miratimin nga Rektori, pastaj vijohet me njoftimin në webin e UNYT-së si dhe të mediave të njohura; gjithashtu edhe në portalin European Euroaxxes për aplikant ndërkombëtar. Thirrjet janë të bazuara në kërkesat ligjor të arsimit të lartë dhe të Kodit të punës. Pas përfundimit të kohës së aplikimeve komisioni rekrutimit që përbëhet nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, dhe sipas nevojës një anëtar i stafit akademik, një nga zyra e Burimeve Njerëzore shqyrton dhe vlerëson aplikimet e kandidatëve dhe përcaktojnë një short list me kandidatët më potencial për ti thirrur në intervistë. Pikat kryesore ku përqëndrohet komisioni janë: a) grada shkencore e aplikantit b) përvoja në mësimdhënie- filozofia në këtë aspekt c) përvoja në kërkimin shkencor. Pas përfundimit të intervistës komisioni bazuar në vlerësimet për kandidatët mundëson rekrutimin e stafit sipas vijimit të procedurave nga Njësia e Burimeve Njerëzore. Evidencë janë Aneksi 4.25; 4.25.1
--	---

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit bazuar në evidencat sipas Aneksit 2.1; për stafin akademik me gradën MSc të cilët janë pjesë e procesit të organizimit të laboratorëve, Aneksit 4.3 për shërbimet mbështetëse aneksit 4.4 për nevoj të shërbimit higjeno sanitar, aneksit 4.5 për asistimin e mbrojtjes kundër zjarrit të ndërtesës, aneksit 4.6 trajnimi i stafit për sigurinë; aneksit 4.14; aneksi 4.15 për politikat e stafit në instalimin e programeve softuerike që janë të domodoshme për zhvillimin e orëve të mësimdhënies në studio arkitektonike; si edhe aneksi 4.17 për shërbimet e IT-së.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit nëpërmjet një sistemi të detajuar të të dhënave për stafin e angazhuar (Turnitin), në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. Zyra ligjor në UNYT harton një dokumenta që firmoset nga stafi kontraktuar për përdorimin e këtyre të dhënave nga databaza e brendshme. Madje CV e secilit kandidat akademik për qëllime transparence janë unifikuar sipas APA style për të qënë të publikuara në faqen zyrtare të UNYT https://www.unyt.edu.al/index.php/faculty/. Evidencë janë Aneksi 4.22 dhe 4.23
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Pranë UNYT ndodhet zyra e karrierës e cila jep udhëzime të vecanta për studentët e këtij program për realizimin e praktikës profesionale. UNYT ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe nëpërmjet zyrës së karrierës mundëson realizimin e praktikës në simestrin e dytë të vitit të dytë duke integruar një lëndë specifike të Intershipit. Në këtë aspekt mund të mos ketë pritshmëri student në arritjen e rezultateve sepse nuk ndiqet nga stafi akademik gjatë intershipi- dhe duke qënë se industria e ndërtimit – është shumë e zënë me projekte, problem që praktika mund të realizohet thjesht për të përfituar kreditet ekziston. Për diplomat UNYT disponon staf akademik të ndjek- udhëheq punimet e diplomave që aktualisht janë në një numër studentësh që lehtësisht mund të udhëhiqen nga stafi akademik PAE dhe PAK. Lënda e shkrimit akademik duhet të jetë e orientuar në mënyrë që student të shkruajë ese të lidhura me lëndët që zhvillon; për shkrimin e rapoteve të praktikës, pra në kontekstin kërkimor për fushën sepcifike, atë të kërkimit në fushën e arkitekturës Evidenca Aneksi 1.22(1;2;3) Aneksi 2.2 aneksi 2.11.
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e	Për sa u diskutua dhe u lexua nëpër dokumentat për akreditimin e këtij programi lidhur me ekzistencën e personelit mbikqyrës në ambjentet pritëse, mendojmë që edhe pse UNYT ka kontrata, marrëveshje me institucione të ndryshme, studio projektimi etj, <i>gjykojmë që studentët janë për të kryer praktikën e cila është e papagueshme dhe nuk kanë një mbikqyrës në këto organizata apo studio ku ata shkojnë, pasi pritësit nuk</i>

detyrimeve / raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	kanë asnjë përgjegjësi për përfitim të tyre profesional. Kjo mund të coj në mos përpmbushjen cilësore efektive të detyrimit të praktikës në atë çfarë student duhet të nxër për aplikimin praktik të dijeve të marra nga teoria gjatë praktikës, dhe që të mund ti japim një vlerësim të duhur për këtë subjekt. Do të ishte e nevojshme ndjekja e studentëve nga mentor gjatë praktikës për të përfutur sa më shumë. Në lëndën e Statikës sipas CV-së së stafit akademik rezulton se titullari që mban gradën PhD ka studiuar Arkitekturë dhe nuk mund të jetë titular i një lënde Inxhinjerie. Asistenti i lëndës së Statikës është me gradën Msc, ndërkohë që për këtë lëndë ka kandidatë që plotësojnë kriteret për të qënë titular me PhD, madje sipas Cv nuk ka as eksperiencë në mësimdhënie për këtë gruplëndësh. Të njëjtat komente si më sipër vlejnë dhe për lëndën Teori Strukturash (Arch 404) me të njëjtë titular dhe asistent sikurse në lëndën e Statikës. Lënda Metoda e avancuar e kërkimit (shumë mirë mund të shkrihet me metoden e shkrimit akademik – nuk është e nevojshme për të bërë tre lëndë(dy shkrime akademike) dhe metodën e avancuar të kërkimit – pasi një shkrim akademik është i mjaftueshëm së bashku me metodën e avancuar të kërkimit për qëllimin e përgatitjes sa më të mirë të Arkitektit. Në formimin e Arkitektit nëse baza e krijimit të programit ka qënë Hollanda, Italia, Lënda e teknologjisë së ndërtimit duhet të jetë pjesë e kurikulës për formimin sa më të mirë të Arkitektit sepse dhe në TU Delft në këtë program Msc Arkitekturë ky është një syllabus detyrues për njohjen nga ana fizike e ndërtesave, materialet, dizajnin e fasadës dhe sistemet klimatike.
Konkluzione	GVJ konkludon se UNYT ndjek një procedurë të qartë dhe transparente për rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ, bazuar në nevojat e programit dhe në përputhje me Statutin e universitetit. Kontratat e punës ndahen në tre formate kryesore: me kohë të plotë e afat të pacaktuar, me kohë të pjesshme dhe me kohë të plotë e afat të përcaktuar, veçanërisht për stafin MSc. Për pozicione që mbulojnë edhe detyra menaxheriale si Dekan apo Përgjegjës Departamenti, kontratat përmbajnë klauzola të veçanta. UNYT jep përparësi kandidatëve të diplomuar në institucione ndërkombëtare dhe i qëndron besnik një procesi konkurrues për përzgjedhjen e tyre. Staf i përzgjidhet në bazë të përgatitjes shkencore dhe përvojës në mësimdhënies edhe asaj kërkimore. Për çdo vit akademik ruhet qëndrueshmëri në përbërjen e stafit, ndërsa për mësimdhënien dhe detyrat ndihmëse angazhohet edhe staf i jashtëm me kontratë. Procesi i rekrutimit përfshin miratimin nga organet drejtuese dhe publikimin e vendeve vakante në platformat përkatëse. Përveç stafit akademik, UNYT siguron edhe staf ndihmës dhe teknik për mbështetjen e mësimdhënies dhe praktikës profesionale. Administrimi i të dhënave të stafit bëhet në mënyrë të centralizuar dhe në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Praktika profesionale zhvillohet në vitin e dytë të studimeve dhe mbështetet nga Zyra e Karrierës, megjithatë nevojitet forcimi i mentorimit akademik gjatë praktikës dhe aftësive të të shkruarit akademik për studentët e Arkitekturës, pasi studentët duhet të orientohen nga supervizorët e shkollës dhe në kryerjen e Intershipit- jo të mbetet thjesht një lëndë për të shkruar një raport.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Sipas vizitën në UNYT u konstatua se infrastruktura aktuale e kampusit të ri tepër funksional me të gjitha fasilitetet, lejon një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor dhe kërkimit për atë numër studentësh maksimumi 25 në vitin më të mirë akademik, në përputhje me natyrën e programit duke respektuar standardet që studentëve- stafit ti ofrohet një cilësi e kënaqshme. Mjediset mësimore janë të përshtatshme për zhvillimin e metodave të mësimdhënies. Me klasa të pajiaura me kompjuter për realizimin e studiove arkitektonike dhe në to gjenden të instaluar programet softuerike që mundësojnë përdorimin e detyrueshëm. Studentëve dhe stafit i ofrohet mbulim me wi-fi dhe akses në internet në të gjithë kampusin. Të gjitha këto zona janë të mobiluara dhe të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për mësimdhënien, për punimet në kohën e lirë, leximin, për qëndrimin. Institucioni është i pajisur me klasa, salla, ambiente biblioteke, ambiente informatikë si dhe zyra për personelin administrative që janë të përshtatshme, të nevojshme dhe të mjaftueshme për këtë program studimi sipas klasave të dedikuara. Ndërtesa e UNYT është e pajisur me sistem qendror ngrohjeje dhe ftohjeje, uji dhe burimet alternative të energjisë krijojnë kushte të rehatshme për mësimdhënie, mësimnxënie dhe hulumtime në kampus. Ambientet e disponueshme janë të përshtatshme për të lejuar studentët dhe stafin e UNYT-së të kryejnë aktivitetet e tyre, të studiojnë si dhe të socializohen. Evidencat Aneksi 4.11: Aneksi 4.4 Aneksi 4.14 Aneksi 4.10 Aneksi 4.13 UNYT ofron menaxhim efektiv dhe kontroll të vazhdueshëm për të garantuar arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e këtij procesi. UNYT organizon dhe lehtëson shërbime për studentë, siç janë aktivitetet promovuese, laboratorë kompjuterash, ambiente kërkimore dhe ambiente zyrash për stafin akademik, administrativ, si dhe për drejtuesit institucionalë.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e	Mjediset mësimore të si klasat, laboratorë, studio, biblioteka dhe mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Për realizimin e programeve UNYT konstatohet se garantohet infrastrukturën e nevojshme të studimeve të nivelit të parë, nivelit të dytë dhe programeve të integruara të nivelit të dytë që ofron. Me një investim të ri duke filluar

teknologjiive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	prej vitit akademik 2022–2023, kampusi i UNYT u zgjerua në vitin akademik 2023–2024 ku zhvillohen aktivitetet në dy kampuse. Ky investim për Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore si dhe Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit ofron një hapësirë shfrytëzimi të mjaftueshme për studentët dhe personelin akademik dhe atë administrativ dhe ofron ambiente bashkëkohore, me pajisje dhe teknologji modern si projector, kompjutera, kamera, pajisje audio, video, dixhitale etj. Evidence Aneksi 4.11 ;Aneksi 4.12 ;Aneksi 4.14; Aneksi 4.15; Aneksi 4.16; Aneksi 4.17
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar vizitës në objekt kampusin e UNYT-së u konstatua se laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Bibloteka është një ambjent modest në të cilin ndodhet fondi i lëndëve të programit në formë të shkruar; dhe në formë elektronike. Në këtë bibliotekë ndodhet dhe fondi i librave të updatuara së fundmi që plotësojnë kërkesat e programit. Për rastin e organizimit të ndonjë eventit ndiqen disa procedura për mundësin e organizimit nga secili program studimi në ndodhet në kompleks. Evidenca Aneksi 3.20 Aneksi 3.21 Aneksi 4.2 dhe 4.9
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni i arsimit të lartë siguron sipas natyrës së programit të studimit që ofron, laborator të teknologjisë së informacionit, pajisje me programe profesionale softuerike si paketa Office 365, Cad, Revit etj Studentëve ju krijohen premisa për të patur akses në koleksionin e librave dhe revistave shkencore, në librarion online Turnitin; JSTOR, Emerald, revista shkencore me bazë të të dhënave të ESC. Aneksi 3.20 Aneksi 3.21 Aneksi 4.9 4.15;4.17
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, thekson se janë evidentuara sa vijon, gjatë vizitës në Universitetin e Neë Yorkut në Tiranë (UNYT), se infrastruktura e kampusit të ri është funksionale dhe e pajisur me të gjitha fasilitetet e nevojshme për një zhvillim normal të mësimdhënies dhe kërkimit, në përputhje me standardet e cilësisë dhe kapacitetin e studentëve të pranuar. Mjediset janë të përshtatshme për metoda moderne të mësimdhënies, të pajisura me kompjuterë dhe programe softuerike të nevojshme për studiot arkitektonike, si dhe me</i>

	akses të plotë në internet. Ambientet përfshijnë klasa, laboratorë, studio, biblioteka dhe hapësira të tjera për lexim, punë individuale dhe qëndrim, të gjitha të pajisura me sistem ngrohjeje/freskimi dhe burime alternative energjie. Kampusi i ri, i zgjeruar që nga viti 2023–2024, shërben për fakultetet e Drejtësisë, Shkencave Shoqërore, Ekonomisë dhe Biznesit, duke ofruar ambiente moderne me teknologji si projektorë, kompjuterë dhe pajisje dixhitale. Institucioni garanton menaxhim efektiv dhe ofron shërbime të vazhdueshme për studentët dhe stafin, përfshirë laboratorë informatikë të pajisur me programe si Office 365, AutoCAD, Revit, etj., dhe akses në burime akademike online si JSTOR, Turnitin, Emerald. Biblioteka përmban literaturë të përditësuar në formë fizike dhe elektronike, ndërsa për veprimtari të veçanta, ndjekën procedura të organizimit sipas programeve studimore. Gjithashtu, UNYT ofron mjedise të përshtatshme për praktika profesionale dhe bashkëpunime institucionale, duke përmblusur të gjitha kërkesat për zhvillimin teorik dhe praktik të studentëve sipas objektivave të programit të studimit			
Shkalla e përmblusjes së standardit	Nuk përmblushet	Përmblushet pjesërisht	Përmblushet kryesisht	Përmblushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në referim të syllabuseve konstatohet se updatimi i literaturës është për autorët e detyruar me publikimet e tyre që i përkasin periudhës 2019-2024 dhe plotësojnë kriteret për përditësim brenda 5 viteve të fundit, përveç literaturës bazë kanë edhe literaturë rekomanduese, e cila është në anglisht për çdo subjekt. Literatura gjendet në bibliotekën e kampusit, sipas planit të buxhetit konstatohet se parashikimet janë sipas kërkesave që programi duhet të përmbush me stafin e atij akademik dhe me pajisjet përkatëse, rritjen profesionale- pjesëmarrje në konferenca, study tour etj. Evidenca Aneksi 2.2 dhe Aneksi 3.22.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Shefi i departamentit dhe drejtorët e programeve me synimin e planifikimi të buxhetit akademik, hartojnë një plan të detajuar për numërin e materialeve studimore që duhen për në bibliotekë për suportin e programeve studimore, planifikim për aktivitetet shkencore të stafit akademik; planifikimin e udhëheqësve për student, për abonimin vjetor të burimeve elektronike dhe biblioteka online e cila u shpërndahet njëjtë të gjithë studentëve. Referimi sa më sipër është mbi bazën e takimit në ambjentet e UNYT në Aneksin 4.9; Aneksin 3.22.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Institucioni që nga krijimi ka vënë në dispozicion të studentëve Bibliotekën qendrore që ndodhet në kat katër të godinës kryesore të Universitetit dhe ka një sipërfaqe 120 m ² , gjithashtu me ndertimin e korpusit të ri është dedikuar një bibliotekë me sipërfaqe prej 70 m ² me rreth 30 poste studimi për tu aksesuar nga studentët të materialeve akademik që stafi akademik bazuar në shtëpi botuese prestigjioze si

barabartë nga studentët e programit të studimit.	Cambridge University Press, Pearson McGraw Hill, Oxford Press etj. ka marrë në konsideratë. Bibloteka në dispozicion të studentëve të arkitekturës ndodhet në katin zero të godinës së Re të Kampusit dhe ofron mundësi të njëjta për të gjithë studentët nëse duan të përdorin materiale e printuara dhe që gjenden në bibliotekë. Evidenca Aneksi 4.12 dhe 4.13.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është e pajisur me fond fizik tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit, por janë në numër jo të konsiderueshëm marrë në konsideratë numërin e studentëve në cdo vit në këtë Degë. Megjithatë për një plotësim të kushteve dhe nevojave të studentit UNYT i ka pajisur studentët me katalogun elektronik për të huazuar materialet; gjithashtu mund të përdorin dhe kartën e studentit bazuar në Aneksin 4.9 lidhur me politikat dhe huazimin e materialeve nga biblioteka http://library.unyt.edu.al . Bazuar në politikat e procedurës së bibliotekës konstatohet se ata përdorin systemin LibrarySoft për regjistrimin e materialeve, këto materiale vijnë nga porositë e bibliotekës dhe burimeve elektronike Emerald Insight, PROQUEST etj. Të cilat janë të aksesueshme dhe në laboratorë, dhe në ambiente të tjera të kampusit, madje disa prej tyre dhe jashtë kampusit.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Universiteti është abonuar në dy burime elektronike prestigjioze Emerald Insight dhe Ebscohost për të siguruar materiale të domosdoshme dhe suplementare për studentët pa pagesë dhe për shfrytëzimin e tyre sa me efektive. Abonimi ka filluar në 2023 për Ebscohost dhe bëhet pas cdo viti rinovimi. Që me krijimin universiteti ka patur që në 2002 abonimin me emerald insight. Në vijim ka një bashkpunim me Empire State College ku si studenteve dhe stafit akademik i ofrohet qasje e të dhenave si APA, Gale Sage etj,
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Aktualisht gjatë vizitës u konstatua se në bibliotekë janë 8 copë kompjutera të lidhura për tu përdorur nga studentët, dhe zona e bibliotekës është e mbuluar me wireless, e cila ishte funksionale dhe krijon mundësi për përdorim nga të gjithë studentët.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në oraret që ata janë në studim dhe konsideron të përshtatshme me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, por biblioteka sipas orari të afishuar tregon se ishte e hapur cdo ditë të javës nga ora 9-19 dhe gjatë fundjavës nga ora 9-17, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Gjithashtu bazuar në evidencën aneksi 4.9.1 tregohet që orari i bibliotekës është afishuar në faqen elektronike http://unyt.edu.al/facilities -3.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të	Bazuar në evidencën aneksi 4.9 lidhur me politikat dhe procedurat e bibliotekës si dhe vizitës në terren, konstatohet se Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online për titujt kryesorë të pranishëm në

pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	shërbim të programit dhe përditësimin, e tyre ne perputhje me kërkesat akademike Shkalla e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, nëpërmjet përdorimit të sallave të studimit që janë të shtrira në katin zero të ndërtesës janë të efektshme dhe duket se ka përpjekje dhe zbatim të kërkesave për pasurimin e fondit fizik, atij online, për tituj, të cilat ndikojnë dhe në performancën e personelit akademik, rritjen profesionale të studentëve.			
Konkluzione	GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, konstaton se UNYT është e pajisur me literaturë të përditësuar, ofron burime elektronike ndërkombëtare, ambiente të përshtatshme për studim dhe politika të qarta për menaxhimin e fondit. Përdorimi dhe shfrytëzimi i saj shihet si efektiv dhe në përputhje me nevojat akademike. Autorët janë të detyruar të përditësojnë literaturën çdo 5 vite (2019–2024). Përveç literaturës bazë, ka edhe literaturë rekomanduese, kryesisht në anglisht. Librat dhe materialet janë të aksesueshme në bibliotekën e kampusit. Bibliotekat janë të pajisura me fondi fizik (tekste bazë, libra shkencorë, revista në shqip e gjuhë të huaja). Studentët kanë akses në katalogun elektronik dhe huazim me kartë studenti. Sistemi LibrarySoft përdoret për regjistrimin e materialeve. Universiteti është i abonuar në: <i>Emerald Insight</i> (që nga 2002). <i>EBSCOhost</i> (që nga 2023, rinovohet çdo vit). Bashkëpunim me Empire State College ofrohet qasje në APA, Gale, Sage etj. Biblioteka ka 8 kompjutera, e gjithë zona mbulohet nga interneti <i>ëireless</i>. Orari publikohet edhe në faqen zyrtare të universitetit. Monitorohet cilësia e fondit fizik dhe online. Shfrytëzimi i sallave të studimit është i efektshëm. Ka përpjekje për pasurim të vazhdueshëm të fondit akademik e cila ndikon pozitivisht në performancën e stafit dhe zhvillimin profesional të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me	Në UNYT kanë pasur që nga fillimi në 2003 një sistem të mëparshëm për menaxhimin e informacionit GNOMON, që realizon aksesin e studentëve, hedhjen e mungesave, notave, lidhja e tyre me plan programin akademik, por që nga viti 2023 është një platformë e re KION

studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin në programin e studimit.	e cila bën të mundur regjistrimin e studentëve dhe procese të tjera sidomos mundësin e kryerjes së regjistrimit online të lëndëve. Personeli akademik ka mundësi të aksesojë listën e studentëve dhe gjithashtu risi e kësaj platforme është që personeli akademik ka mundësinë e shkarkimit të listës së prezencës së studentëve dhe hedhjen e mungesave, bazuar në Aneksi 4.21.3 mundëson dhe hedhjen e vlerësimeve të studentëve në KION nga stafi akademik. Tashmë me këtë sistem studentët mund të regjistrohen direkt pasi finalizojnë U-Albanian dhe dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar si pjesë e dosjes personale të secilit deri në momentin e diplomimit. Gjatë fillimit dhe deri në përfundim është dhe Sekretaria mësimore që ka një rol të rëndësishëm që nga të dhënat personale deri në ndjekjen e procesit të përvitshëm deri në diplomimin e tyre. Evidenca për këtë janë Aneksi 4.1: 4.20(nga 1-9 sistemi vjetër);4.21(1,2,3,4,6 sistemi i ri KION).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin bazuar në Aneksin 4.18. Zyra e Burimeve Njerëzore ka të organizuara në mënyrë fizike dhe elektronike dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ që nga aplikimi deri në ditën që ne kemi qënë present për inspektim në zyrat e tyre dhe në ndërtesat e të dy komplekseve të UNYT-së; duke arkivuar herë pas herë të gjitha updatimet e mundshme të stafit. Ky informacion është i bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe gjithashtu në konformitet me rregulloren e Mbrojtjes së të dhënave që UNYT posedon. Kopja e secili është përditësuar dhe në mënyrë digitale duke respektuar rregullat, kërkesat dhe ndryshimet ligjore në RSh. Sistemi menaxhimit KION mundëson akses të dedikuar të informacioni dhe dokumentave për të gjithë – personel (administrativ akademik) dhe studentëve të secili program hapjen e adresës elektronike në bashkëpunim me zyrën e shërbimit të teknologjisë së Informacionit e cila ju dërgohet studentëve për lejim aksesit dhe emaili të universitetit. Evidencat janë bazuar në Aneksin 4.18; 4.19; 4.21(1-6); 4.31;5,31
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Kopja e secili është përditësuar dhe në mënyrë digitale duke respektuar rregullat, kërkesat dhe ndryshimet ligjore në RSh.Sistemi menaxhimit KION mundëson akses të dedikuar të informacioni dhe dokumentave për të gjithë – personel (administrativ akademik) dhe studentëve të secili program hapjen e adresës elektronike në bashkëpunim me zyrën e shërbimit të teknologjisë së Informacionit e cila ju dërgohet studentëve për lejim aksesit dhe emaili të universitetit. Aneksi 4.21(1-6);
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit KION ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve duke mundësuar përdorimin nga studentët, sekretaria dhe personeli akademik duke komunikuar për programin mësimor por jo vetëm. Evidenca Aneksi 4.21
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale	Sistemi i menaxhimit updatohet në kohë reale duke nxjerr listë notave në bazë të lëndëve, mungesat, detyrimet e lëndëve të programit , raportimet

të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	në Sekretari nga ana e stafit akademik apo ndihmës akademik për shlyerjen e detyrimeve të orëve të laboratorit, të shlyerje së detyrimeve të detyrave të kursit- studio etj, pra sistemi KION garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale për organet dhe autoritetet drejtuese për hartimin e raportimeve statistikore gjithashtu. Evidenca Aneksi 4.21.3 dhe 4.21.5			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit zyrtar të UNYT -së dhe kjo faqe është në dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. Nga faqa synohet arritja e informacionit të kërkuar nga të interesuarit student, staf akademik- ndihmës akademik, administrative. Informacioni në faqen e webit përmban informacion në lidhje me programet e studimit të të gjitha cikleve, informacion mbi personelin akademik, detajim të kurrikulës, dhe të gjithë procesin e palikimit si për një regjistrim direct apo dhe ata të transferuar, ku janë të qarta politikat e bursave, dokumentat e kërkuara për rastet e studentëve të huaj. Në ëeb pasqyrohen eventet shkencore dhe social kulturore të UNYT-së, informacion mbi kërkimin shkencor, mbi njësinë e sigurimit të Cilësisë, zyra e Karrierës dhe Alumni, sekretarisë mësimore, zyra e financës, të gjitha qendrat e studentëve. Evidencë http://www.unyt.edu.al/page/about-unity .			
Konkluzione	<i>GVJ ka konstatuar në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit se në Universitetin e Neë York-ut në Tiranë (UNYT), sistemi i menaxhimit të informacionit ka kaluar nga platforma e mëparshme GNOMON (2003–2022) në platformën e re KION që nga viti 2023. KION ofron funksione moderne për regjistrimin e studentëve, menaxhimin online të lëndëve, aksesin e stafit akademik në listat e studentëve, regjistrimin e prezencës dhe të mungesave, si dhe hedhjen e vlerësimeve në kohë reale. Sistemi siguron transparencë dhe monitorim të procesit akademik dhe administrativ, duke ndihmuar si studentët, ashtu edhe sekretarinë mësimore në ndjekjen e ecuresë deri në diplomim. Përveç studentëve, edhe personeli akademik, administrativ dhe ndihmës kanë akses në informacion përmes adresave elektronike të dedikuara, të krijuara në bashkëpunim me shërbimin e IT. Dokumentacioni i stafit menaxhohet si në formë fizike ashtu edhe elektronike, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me rregulloret përkatëse të UNYT. Sistemi KION është i integruar me module komunikimi interaktiv ndërmjet stafit dhe studentëve, dhe përditësohet në kohë reale me të dhëna mbi notat, mungesat, detyrimet mësimore dhe raportimet statistikore për organet drejtuese. Krahas kësaj, informacioni mbi programet e studimit, personelin, kurrikulat, bursat dhe aktivitetet shkencore e kulturore publikohet në faqen zyrtare të universitetit në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), duke ofruar transparencë dhe qasje të gjerë për studentët dhe publikun.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në aneksin 4.31 dhe aneksin 4.7 si edhe gjatë vizitës u konstatua se Institucioni i arsimit të lartë harton raporte financiare vjetore lidhur me kostot të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit si edhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi duke mbajtur në konsideratë analizën e të ardhurave, shpenzimet operationale, pagat për stafin administrative, akademik dhe ndihmës akademik, ujë drita, energji, telefoni internet që janë pjesë përbërëse e këtij programi.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbanë financimin e burimeve njerëzore (stafit administrative-akademik- ndihmës akademik) që janë në shërbim të realizimit të programit. Për realizimin e programit janë analizuar kostot e kompjuterave, pajisjeve IT, mobile dhe asete të tjera; programet kompjuterike, biblioteka elektronike, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Buxheti në varësi të nevojave të departamenteve planifikohet përgjithësisht në muajin Prill- Maj të vitit akademik me qëllim që departamenti i programit të studimit të ketë mundësi të planifikojë në rast të vëndeve vacant, për zhvillimin e punimeve kërkimore shkencore bazuar në një listë të detajuar aktiviteteve. Ky proces i buxhetimit pasi përfundon në njësitë përkthëse të departamentit kalon për miratim pranë Senatit Akademik dhe bordit të UNYT-së. Evidencat nga aneksi 3.27 dhe 4.32
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në këtë institucion realizohet auditimin i jashtëm vjetor kundrejt zyrës së financës në lidhje me arritjen e objektivave, për besueshmërinë e manaxhimit si dhe përputhshmërisë së shpenzimeve të realizuara dhe të ardhurave. Qëllimi është efikasiteti i përdorimit të fondeve. Auditimi i jashtëm kryhet nga kompani të certifikuar të auditimit të pavaruar, të cilët shqyrtojnë dokumentacionin kontabël dhe fiskal, transaksionet e kryera nga UNYT nëpërmjet sistemit të menaxhimit financiar ERP-së. Evidencë është aneksi 4.30
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në aneksin 4.31 rezultojnë se institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës duke ju referuar nevojave dhe kërkimeve për ecuri normale të programit. Bazuar në Ligjin nr. 25/2018 konstatohet se mbahen dokumentat financiare dhe raportet në mbyllje të ciklit të studimit për vitin akademik nga UNYT nga ku analizohet ecuria financiare.

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	UNYT ka ngritur kapacitete të mjaftueshme në menaxhimin financiar, duke ndjekur praktikat e kontabilitetit sipas Standardeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Institucioni përgatit rregullisht pasqyra financiare dhe buxhete, të cilat shërbejnë për transparencë dhe marrje vendimesh nga administrata dhe organet drejtuese. Çdo vit hartohet një buxhet gjithëpërfshirës që parashikon shpenzimet dhe burimet financiare, duke u fokusuar kryesisht tek pagesat e shkollimit si burimi kryesor i të ardhurave. UNYT monitoron zbatimin e buxhetit krahasimin e tij me buxhetet e kaluara dhe përgatit raporte për menaxhimin e riskut financiar. Institucioni gjithashtu kryen auditime të brendshme e të jashtme, bën parashikime të të ardhurave dhe menaxhon me kujdes flukset monetare. Në këtë kuadër, mbështetja e Fondacionit ka luajtur një rol të rëndësishëm në garantimin e stabilitetit financiar dhe zhvillimit të vazhdueshëm të programeve studimore.			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara se Institucioni i Arsimit të Lartë(UNYT) harton raporte financiare vjetore të detajuara për kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit, duke përfshirë planin e mbështetjes financiare për një cikël të plotë studimi. Raportet marrin në konsideratë të ardhurat, shpenzimet operationale, pagat e stafit administrativ, akademik dhe ndihmës, si edhe shpenzimet për energji, ujë, internet, mirëmbajtje, biblioteka dhe literatura mbështetëse. Në planin e financimit përfshihen gjithashtu kostot për pajisje IT, programe kompjuterike, asete të tjera, si dhe grantet apo kontratat e shërbimeve të lidhura me realizimin e programeve.</i> <i>Procesi i buxhetimit zhvillohet zakonisht në periudhën prill-maj, në varësi të nevojave të departamenteve, duke lejuar parashikimin e vendeve vakante dhe planifikimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore. Pas përfundimit, buxheti kalon për miratim në Senatin Akademik dhe Bordin e UNYT. Institucioni raporton në nivel njësie bazë mbi realizimin e buxhetit të vitit paraardhës dhe mban dokumentacion financiar sipas kërkesave të Ligjit nr. 25/2018.</i> <i>Gjithashtu, UNYT i nënshtrohet auditimit të jashtëm vjetor nga kompani të certifikuara të pavarura, të cilat shqyrtojnë dokumentacionin kontabël e fiskal, si dhe transaksionet e realizuara përmes sistemit të menaxhimit financiar ERP, me qëllim sigurimin e besueshmërisë, përputhshmërisë dhe efikasitetit të përdorimit të fondeve.</i> <i>Në përfundim, UNYT ka ngritur kapacitete të mjaftueshme në menaxhimin financiar, duke ndjekur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, hartuar pasqyra financiare dhe buxhete gjithëpërfshirëse, dhe duke siguruar transparencë e stabilitet financiar për mbështetjen afatgjatë të programeve studimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UNYT, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe aktet ligjore e rregullatore, ka përcaktuar kriteret e pranimit të studentëve, ku përfshihet edhe njohja e gjuhës angleze, pasi studimet zhvillohen në këtë gjuhë. Kriteret e pranimit miratohen nga Senati Akademik dhe pasqyrohen në vendimet përkatëse. Përveç kësaj, universiteti organizon aktivitete informuese si ditë të hapura, vizita studentore, kurse maturantësh, panaire pune e studimi, si dhe provimin e bursës. Procesi i aplikimit kryhet përmes portalit shtetëror U-Albania, ku maturantët përzgjedhin deri në 10 programe studimi. Regjistrimi final varet nga shpallja e fituesve në raundet përkatëse të MAS dhe procedurat e RASH. Zyrat e UNYT dhe stafi ofrojnë asistencë për kandidatët gjatë këtij procesi. Të gjithë studentët e regjistruar pajisen me kartën e studentit në bashkëpunim me QSHA dhe Ministrinë e Arsimit. Evidence aneksi 1.2; 1.7;5.1;5.2;5.4;5.5;5.6;5.8;5.9;5.9.1;5.24
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në përputhje me nenin 6 të Statutit të UNYT "Liria Akademike dhe Mundësitë e Barabarta", universiteti garanton se në të gjitha programet e tij zbatohen politika të barazisë pa asnjë lloj diskriminimi. UNYT është i angazhuar të promovojë diversitetin dhe të sigurojë kushte të barabarta pranimi për studentët, pavarësisht prejardhjes etnike, racës, fesë, orientimit seksual, statusit personal apo aftësive fizike. Rregulloret e programeve parashikojnë qartë procedurat dhe praktikatat që lidhen me gjithë ciklin e studimeve, nga regjistrimi e deri tek përfundimi apo transferimet, duke u mbështetur në Kodin e Procedurave Transparente që garanton trajtim të barabartë për çdo kandidat. Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, UNYT ka ngritur Këshillin e Etikës, i cili mbikëqyr respektimin e të drejtave të parashikuara në Kodin e Etikës si për studentët ashtu edhe për stafin akademik e administrativ. Universiteti ofron gjithashtu infrastrukturë të përshtatshme për studentët me nevoja të veçanta fizike, si ashensorë dhe ambiente të aksesueshme. Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike merr në konsideratë diversitetin kulturor, social e ekonomik të studentëve dhe ofron mbështetje të përshtatur ndaj nevojave të tyre. Shërbimet e kësaj qendre ndihmojnë studentët në përballimin e vështirësive personale, sociale dhe akademike, duke lehtësuar përshtatjen me jetën universitare dhe duke

	ofruar asistencë në procesin e të nxënës. Për më tepër, UNYT garanton të drejtën e ankimimit për çdo student që ndjehet i trajtuar në mënyrë të pabarabartë. Referuar aneksit 3.1
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në procesin e pranimi dhe regjistrimit, UNYT zbaton vendimet e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimet e MAS, si dhe kriteret e pranimi sipas ligjit dhe vendimeve të Senatit. Për çdo vit akademik, UNYT harton dhe publikon listat e aplikantëve sipas renditjes së fituesve, bazuar në kriteret e përcaktuara nga ministria dhe vendimet e Senatit. Aneksi 5.2
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UNYT në procesin e pranimi dhe regjistrimit, zbaton vendimet e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimet e MAS, si dhe kriteret e pranimi sipas ligjit dhe vendimeve të Senatit duke hartuar dhe publikuar listat e aplikantëve sipas renditjes së fituesve, bazuar në kriteret e përcaktuara nga ministria dhe vendimet e Senatit. Studentët e huaj pranohen duke respektuar procedurat përkatëse, përfshirë kërkesat për dokumentacionin e nevojshëm dhe njohjen e gjuhës së mësimi (anglisht), sipas niveleve të pranura ndërkombëtarisht (TOEFL, IELTS, APTIS, etj.) sipas vendimit të senatit nr.89, ndërsa për mbrojtje e gjuhës angleze zbatohet udhëzimi nr.52, i cili zhvillohet në ambjentët e UNYT në bashkëpunim me British Council/ Aptis, gjithashtu ndihmon studentët sipas kurseve ESL për përmirësimin e njohurive gjuhësore. Për transferimin e studentëve në programet e studimit të UNYT, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumente si: formularin e aplikimit, kopje të noterizuara të diplomës dhe listës së notave, kopje ID ose pasaporte, katër fotografi dhe certifikatën e njohjes së gjuhës angleze (B1/ B2). Procedurat zhvillohen sipas Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe vendimeve përkatëse të Senatit Akademik. Komisioni i transferimeve vlerëson dokumentacionin dhe përcakton njohjen e krediteve, duke pranuar maksimumi gjysmën e tyre nga institucioni i mëparshëm. Studentët duhet të paraqesin gjithashtu planin mësimor (syllabus) për të ndihmuar në vlerësimin e barazvlefshmërisë së krediteve. Kriteret e pranimi janë të publikuara dhe studentët informohen nga zyra përkatëse e UNYT. Aneksi 2.9;5.2;5.28
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	IAL informon të interesuarit me anë të faqes së ëëbit për të gjitha programet, i cili azhurnohet kohë pas kohe me ndryshimet në programet e studimit, kurrikulat etj për tju dhënë mundësinë të gjithëve atyre që janë pjesë e UNYT-së (student, staf akademik) si edhe studentëve që kërkojnë të jenë pjesë e UNYT. Në faqen zyrtare gjithashtu afishohen dhe aktivitetet akademiko-shkencore, social, kulturor dhe aktivitetet e studentëve që updaten çdo ditë. Ka disa mënyra sesi UNYT informon studentët të behen pjesë e veprimtarisë akademike duke ndjekur programet sic janë, gazetatat, reklamat në TV, aktivitete arsimore me natyre promovuese, broshura fletëpalosje, panairë brenda dhe jashtë Shqipërisë meqë programi është në Anglisht. UNYT u jep mundësi

	bursash studentëve të cilët i nënshtrohen konkurseve të maturës falas (Matematikë, Gjuhë, Letërsi, Anglisht), kurse të arkitekturës (që janë në të dy format online dhe fizikisht për mundësi shume më të mira të atyre që kanë interes për arkitekturën) dhe provimit të fitimit të bursës deri në 100%. Evidenca aneksi 5.6;5.5;5.8;5.25
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve bazuar në ushëzimin e Ministrisë së Arsimit me nr.10 datë 30.06.2023. Kuotat e studentëve janë bazuar në të dhënat që ky program ka pasur studentë të regjistruar cdo vit. Në kuotat e publikuara IAL- ndjek dhe politika lehtësuese për studentët që kanë një kategori të vecantë sociale (sipas citimit në kriterin 6). Peticionet financiarë janë disa forma të lehtësimit të pagesave sipas rasteve të studentëve. Evidenca Aneksi 5.3;5.30.1
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kuotat e studentëve të huaj janë bazuar në të dhënat që ky program ka pasur nga studentë të huaj që tashmë janë regjistruar në cdo vit në këtë program. Kriteret për studentët e huaj gjithashtu miratohen me vendim Senati Akademik dhe bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Megjithatë për këtë program ofrohet në anglisht, nga studentët kërkohet të zbatohet kriteri për testimin institucional ose certifikimi përkatës i njohjes së anglishtes (niveli B1/B2) bazuar në udhëzimin nr. 52/03.12.2015 për pranimet të ciklit të parë dhe të dytë në programet e studimit të njohjes së gjuhës së huaj. Evidencë Aneksi 5.2;5.3
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Pranë UNYT është ngritur zyra e çështjeve të studentëve e cila mbledh kërkesat e studentëve që kërkojnë mbështetje financiare, dhe përmes vendimeve të komitetit të bursave vlerësohen kërkesat e tyre, bazuar në mesatare dhe në arritjet e tyre kombëtare dhe ndërkombëtare. Praktika e bursave e bazuar në Politikën që UNYT ka në seksionin 1, pika 1.3 faqe 3 ku për studentët me mesatare 9-9.49 përfitojnë 25% bursë, ndërsa ata me mesatare 9.5-9.79 bursë 50% , me mesatare 9.8-9.99 përfitojnë bursë 75%, ata me mesatare 10 fitojnë bursë 100%. Evidenca aneksi 5.7
Konkluzione	<i>GVJ shprehet në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore se Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe aktet rregullatore, Universiteti i Nju Jorkut në Tiranë (UNYT) ka përcaktuar kritere të qarta pranimi, ku përfshihet njohja e gjuhës angleze, pasi studimet zhvillohen në këtë gjuhë. Këto kritere miratohen nga Senati Akademik dhe pasqyrohen në vendimet përkatëse. Procesi i aplikimit realizohet përmes portalit shtetëror U-Albania, ndërsa UNYT ofron asistencë të plotë për kandidatët përmes zyrave dhe stafit të tij. Studentët e regjistruar pajisen me kartën e studentit në bashkëpunim me QSHA dhe Ministrinë e Arsimit. Universiteti zhvillon edhe aktivitete promovuese si ditë të hapura, panairë pune e studimi, provime bursash dhe kurse për maturan të. Në respektim të parimit të barazisë dhe lirisë akademike, UNYT garanton politika të paanshme pranimi, pa diskriminim mbi bazën e etnisë, racës, fesë, gjinisë, orientimit seksual apo aftësive fizike. Ky parim mbështetet nga Këshilli i Etikës dhe zbatimi i Kodit të Etikës, ndërsa Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike ofron</i>

	mbështetje të personalizuar për studentët, duke marrë në konsideratë diversitetin social e kulturor, si dhe nevojat e veçanta. Për studentët me aftësi ndryshe sigurohet infrastrukturë e përshtatshme. Për studentët vendas dhe të huaj, pranimit bëhet mbi bazën e dokumentacionit të kërkuar dhe certifikimit të gjuhës angleze (TOEFL, IELTS, APTIS apo testime institucionale), duke respektuar udhëzimet e MAS dhe vendimet e Senatit Akademik. Procedurat e transferimit të studentëve janë të qarta dhe rregullohen sipas ligjit, me njohje të pjesshme të krediteve nga institucionet e mëparshme. UNYT harton dhe publikon çdo vit akademik kuotat e pranimeve, duke ndjekur udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, si dhe politika lehtësuese për kategori sociale të veçanta. Për më tepër, universiteti ofron një sistem bursash të bazuar në mesataret akademike, arritjet kombëtare dhe ndërkombëtare, ku studentët mund të përfitojnë deri në 100% mbulim të tarifës së shkollimit. Përmes këtyre praktikave, UNYT siguron transparencë, barazi dhe cilësi në procesin e pranimit dhe regjistrimit të studentëve, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të përvojës së tyre akademike dhe sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UNYT bazuar në rregulloren e programit si dhe në ndjekjen e ecures së studentëve nëpërmjet programit KION, përcakton në mënyrë të qartë kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin, notat vlerësimi I performancës së studentëve. Staf i akademik me kohë të plotë ka akses për të parë rezultatet akademike, me qëllimin që të ndjekin ecurin dhe për ti asistuar në lidhje me lëndët që duhet të ndjekin në simestrin pasardhës studnetët. Evidencë Aneksi 1.10;4.21.5
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UNYT bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë si edhe përmes zyrës së çështjeve të Studentëve (SAO) ndjek procedura transparente për informimin apo transferimin e studentëve në rastet kur ata kërkohen njohjen e diplomës së tyre shtetërore nga vende nga vinë(nëse janë nga shtetet të tjera) ose procedura për transferimin nga universitete të tjera duke paraqitur kërkesën dhe rast pas rasti vlerësohen dokumentacionet vijuese dhe plotësuese, detyruese që duhen në mënyrë që Komisioni Ad-Hoc i vlerësimit i ngritur në nivel departamenti të vlerësoj dhe të paraqesi pranë dekanit të fakultetit aprovimin dhe më tej meret miratimi nga Rektorati. Per tu diplomuar, studentët e transferuar duhet të fitojnë të paktën ½ të totalit të kredive në UNYT. Për cdo rast student informohet për transferimin dhe kushtet e vlerësimit e krediteve. Evidenca Aneksi 2.9;5.26

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni UNYT informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit duke i specifikuar ato në Rregulloren e Programit e cila është në përputhje me Sistemin European të Arsimit të Lartë të Kredive si njësi të matjes së ngarkesës së studentëve. Ajo është një document shumë i rëndësishëm dhe presantohet tek studenti kur ai rregjistrohet. Pjesë e rregullores janë dhe mënyra e vlerësimit të studentëve për cdo lëndë të programit që në mënyrë tipike përfshin 30% të finales janë provimet e ndërmjetme; 40% është provimi final; pjesëmarrja në klasë është 10% e finales, 20% përfshin detyra kursi, raste studimore, punë në laborator etj. Evidenca Aneksi 1.10;2.2;3.6;4.1
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	IAL informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit duke ju vënë në dispozicion Rregulloren e Projektit të Diplomimit, rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Departamentit, rregulloren e programit të studimit përcaktojnë të gjitha parakushtet dhe procedurat për Projektin e diplomimit. Struktura opërgjegjëse informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit me qëllim që tju krijoj kushte për realizimin me sukses të programit. Evidenca Aneksi 1.7;1.8;1.9;1.10
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Zyra e çështjeve të Studentëve (SAO) pranë UNYT-së ofron tek studentët e mundshëm kandidatët të cilët kanë vizituar universitetin, bazuar në politikat e Ministrisë së Arsimit për Njohjen dhe Informimin e Maturantëve takime për dhënien e një informacioni të nevojshëm për programin e studimit. SAO ka një plan të qartë takimesh që është pjesë e planit vjetor të veprimit, gjithashtu kjo njësi merr pjesë në panairë të ndryshme të organizuar nga dhoma e tregtisë apo jashtë vendit duke ofruar këshillime të përgjithëshme studimi për të interesuarit. Evidencë Aneksi 5.5;5.27
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore konstaton se UNYT, në përputhje me rregulloret dhe ligjin për arsimin e lartë, ka përcaktuar procedura dhe kriteret të qarta për ecurinë akademike të studentëve. Përmes programit KION monitorohet progresi i tyre, ku stafi akademik ka akses për të ndjekur rezultatet dhe për t'i asistuar në përzgjedhjen e lëndëve të semestrit pasardhës. Në rastet e transferimit ose njohjes së diplomave nga studentë vendas apo të huaj, procedurat trajtohen nga Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) dhe vlerësohen nga Komisioni Ad-Hoc i ngritur pranë departamentit, me miratim përfundimtar nga Rektorati. Studentët e transferuar duhet të përfitojnë të paktën gjysmën e krediteve pranë UNYT për t'u diplomuar. Vlerësimi i studentëve bëhet sipas Rregullores së Programit, e cila harmonizohet me Sistemin European të Krediteve. Metodologjia e vlerësimit përfshin provime ndërmjetëse (30%), provimin final (40%), pjesëmarrjen në klasë (10%) dhe detyra apo punë praktike (20%). Për projektin e diplomimit, studentët informohen për të gjitha parakushtet dhe procedurat përmes rregulloreve përkatëse të programit, fakultetit dhe departamentit, duke u krijuar kushte për përfundimin me sukses të studimeve.</i>

	SAO gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe orientimin e maturantëve e kandidatëve potencialë, përmes takimeve, planit vjetor të veprimit, si dhe pjesëmarrjes në panairë brenda dhe jashtë vendit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) informon studentët duke përdorur email; takime zyrtare; ose nëpërmjet faqes zyrtare, kohëzgjatjen e programit; tarifën e studimit, strukturën e programit etj. Informacioni nga SAO u jepet studentëve edhe në formën e broshurave, ose formati I printuar I dosjes së programit nëse studentët vinë në universitet fizikisht. Gjatë vizitës së tyre atyre ju ofrohet mundësia të takojnë dhe stafin akademik për të krijuar një ide në lidhje me mësimnxënien, sezonet e provimeve, vlerësimi. Informacioni i përcillet për sa më sipër studentëve dhe në formë elektronike. UNYT ka një listë më këshilltar akademik për cdo student, dhe ky informacion i përcillet studentit që javën e parë të fillimit të programit. Evidenca Ankesi 3.4
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	IAL vënë në dispozicion të studentëve që në javën e parë të fillimit të vitit akademik të gjithë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit, planin mësimor, modulet dhe përmbajtjen e lëndëve që program disponon. Të gjitha këto i vihen në dispozicion nga SAO dhe këshilluesi akademik, takime në departament, plan programeve të kursit si dhe përmes faqes së internetit në UNYT, ku gjejnë dhe një informacion të plotë lidhur me njohjen e vlefshmërisë së diplomës. Evidenca aneksi 5.29
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e karrierës pranë UNYT është funksionale dhe aktive bazuar në rregulloren e zyrës së karrierës, ajo është e ngarkuar me përgjegjësinë e mbajtjes së kontakteve me studentët; përcjellë tek ata informacionin mbi mundësitë e punëve me kohe të pjesëshme /të plotë për të realizuar praktikën që synon rritjen e tyre potenciale në lidhje me përthithjen më të mirë të atyre që përcillen gjatë mësimdhënies. Plani vjetor përmban objektivat e qarta të cilat hartohen për cdo vit akademik për operimin më të mirë të Zyrës së Karrierës. Mundësia e kontaktit të kompanive të ndryshme për adresimin e studentëve të bëhen pjesë e tregut të punës në përputhje me profilin e tyre. Panairi i punës është një ngjarje shumë e rëndësishme prej shumë vitesh sepse në të marrin pjesë kompani të ndryshme dhe student informohet për pjesëmarrjen në to me anë të emailit. Në këtë panair ka një aktivitet të larmishëm ndër të cilët dhe ajo dedikuar Alumni të ftuar është histori suksesi për ata të cilët tashmë janë duke u diplomuar apo janë duke u bërë pjesë e projekteve pranë kompanive prestigjioze. Evidenca Aneksi 3.9;(1-2)5.11;5.10; 5.12; 5.12.1; 5.15.2;5.13; 5.16; 5.17; 5.18;5.22

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UNYT orgaznizon ditën e hapur (Open day) në të cilën prezanton ambientet e zhvillimit të mësimi, logjistikën, pajisjet, si edhe një informacion i plotë në lidhje me zyrat, shërbimet e ndryshme në shërbim të studentit. Ditët e hapura organizohen në fillim të vitit akademik në të merr pjesë cdo zyrë pranë UNYT dhe shpërndajnë informacionin sipas kërkesave të studentëve. Evidenca Ankesi 5.29			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi KION krijon mundësin e aksesit për studentët e regjistruar, pasi që në momentin e regjistrimit studentët pajisjet me emër përdorimit dhe kod të aksesimit të sistemit, për notat, mungesat. Studentët mund ta përdori KION dhe online pasi sistemi bazohet në web. Aneksi 4.19;4.21.4			
Konkluzione	GVJ shprehet në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore se UNYT, përmes Zyrës së Çështjeve të Studentëve (SAO), informon studentët mbi programet e studimit, tarifat, strukturën dhe procedurat, duke përdorur email, takime zyrtare, faqen online, broshura apo dosje të printuara. Studentëve u jepet mundësia të takojnë stafin akademik dhe që në javën e parë marrin informacionin e plotë mbi planin mësimor, modulet dhe këshilltarin akademik personal. Në mbështetje të karrierës, UNYT ka një zyrë aktive që lidh studentët me tregun e punës përmes praktikave, punësimeve dhe Panairit të Punës, ku marrin pjesë kompani vendase dhe ndërkombëtare, si dhe prezantohen histori suksesi të alumni-ve. Gjithashtu, universiteti organizon "Ditën e Hapur", ku prezantohen ambientet, logjistika dhe shërbimet për studentët. Ndërkohë, sistemi elektronik KION u mundëson studentëve të aksesojnë online notat, mungesat dhe informacionin akademik që nga regjistrimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Zyra e Karrierës & Alumni si dhe Sekretaria Mësimore kanë informacionin e duhur të studentëve të regjistruar cdo vit, i cili përditësohet në fund të vitit akademik, sipas programeve, notave të studentëve të diplomuar me qëllim sigurimin e të dhënave të punësimit të tyre. Këto dy zyra hartojnë mbi bazën e të dhënave të mësipërme dokumentin e performancës (që gjendet si pjesë e materialeve në aneksin 5.18). Pjesë e këtij raportimi është dhe statuti i studentëve në programet Bachelor, Master dhe PhD lidhur me punësimin e tyre, përputhshmërinë me drejtimin e marrë nga shkollimi. Zyra e Karrierës dhe Alumni mban

	një komunikim të vazhdueshëm me studentët e diplomuar të programeve të tjera sepse për këtë program ky është viti parë që diplomohen dy student. Evidenca aneksi 5.17;5.20.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sistemi KION lejon hedhjen e të dhënave personale, financiare dhe akademike të studentëve, ky sistem përditësohet për rastet e regjistrimit, transferimit, shkeputjes nga program për të gjithë studentët, përfshirë dhe këta të programit të Arkitekturës. Pasurimi i sistemit Kion bën të mundur që ai të gjeneroj raporte në lidhje me diplomimin e studentëve, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik të programit të studimeve që ai ndjek. Këto raporte përdoren nga Sekretaria Mësimore e cila ndjek zbatimin e udhëzimeve të MASH, ASCAL. Evidenca Aneksi 4.21(1-6)
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore është e autorizuar për hedhjen, verifikimin dhe ruajtjen e të dhënave të cilat i realizon nga menaxhimimi i sistemit KION, i cili është lehtësisht i përdorur dhe siguron raportet statistikore. Menaxhimi i të dhënave të studentëve përmes platformës së brendshme i jep mundësi aksesit të kufizuar departamentit në kuadrë të ruajtjes së të dhënave personale. Evidencë aneksi 4.21.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	IAL ka një komision ad-hoc që është pjesë integrale e kontrollit të brendshëm dhe një njësi e specializuar, qëllimi i saj është kontrolli i procedurave dhe rregullave të vendosura në rregullren e funksionimit të zyrave të administratës. Evidenca aneksi 6.14;6.14.1;6.14.2
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë Departamenti përkatës, harton raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore, dhe me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit duke hartuar raporte mbi profilin e studentëve të ardhur, atyre aktualisht shkallën e punësimit të tyre dhe të tjera të dhëna të disponueshme, nga ku rezulton se rreth 97% e studentëve janë të punësuar pranë kompanive prestigjioze. Evidencë Aneksi 5.20
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore konstaton se UNYT, përmes Zyrës së Karrierës & Alumni dhe Sekretarisë Mësimore, mbledh dhe përditëson çdo vit të dhëna mbi studentët e regjistruar, diplomuar dhe të punësuar, duke përgatitur dokumente të performancës që pasqyrojnë gjendjen e tyre në nivelet Bachelor, Master dhe PhD. Komunikimi me të diplomuarit është i vazhdueshëm, ndërsa për programin në fjalë ky është viti i parë</i>

	me diplomantë. Sistemi elektronik KION siguron regjistrimin, përditësimin dhe raportimin e të dhënave akademike, financiare dhe personale të studentëve, duke gjeneruar statistika mbi diplomimet, transferimet dhe tërheqjet nga programet. Këto raporte përdoren nga Sekretaria Mësimore në përputhje me udhëzimet e MASH dhe ASCAL. Kontrolli i brendshëm mbështetet nga një komision ad-hoc dhe njësi të specializuara për monitorimin e procedurave administrative. Ndërkohë, departamentet hartojnë raporte analitike mbi profilin e studentëve dhe shkallën e punësimit, ku evidentohet se rreth 97% e të diplomuarve janë të punësuar pranë kompanive prestigjioze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në referim të statutit të UNYT-së rezultojnë se pjesëmarrja e studentëve është parashikuar të ketë një rol në vendimarrjen institucionale, e drejtë kjo që njihet, mbrohet dhe garantohet nga komuniteti i UNYT-së. Unioni i Këshillit Disiplinor është ngritur bazuar në rregulloren e departamentit për të shmangur çdo mundësi konflikti interesi. Gjithashtu studentët janë të përfshirë dhe në Senat, në Njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, Këshillimin e etikës. Evidenca aneksi 1.1;1.7;2.19
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bauzar në aktet ligjore të funksionimit të UNYT-së rezultojnë se studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në vendimarrjesepse janë pjesë e Unionit të Këshillit Disiplinor, Senatit Akademik, në Njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, Këshillit të etikës, Unionit Studentor dhe një përfaqësues i studentëve është pjesë e Grupit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të Akreditimit. Evidenca aneksi 1.1;1.7;2.19
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Njësia përgjegjëse, departamenti përkatës, duke ju referuar akteve ligjore garanton përfshirjen e studentëve nëpërmjet pyetësorëve të Vlerësimit të zhvilluara çdo simester ata shprehin mendimet e tyre, sygjierimet për përmirësim dhe rishikim e kurrikulave. Grupet (Senati Akademik, Komisioni i përhershëm i sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe organet akademike) që janë pjesë e procesit të hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta fakti që kanë student si anëtar të këtyre focus grupeve) reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament etj. . Aneksi 2.19; 6.9;6.9.1;6.9.2
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit	Studentët janë pjesë e disa komisioneve dhe ata kanë të drejtë të marrin vendime, të këshillojnë apo vlerësojnë një proces.

mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në aneksin 5.30 studentëve ju jepet mundësia e aksesit në formë fizike dhe elektronike të ankimeve, peticioneve. Proceduralisht ka një Zyrë të Çështjes së Studentëve (SAO) që merr në shqyrtim të gjithë llojet e kërkesave ankimeve, peticioneve akademiko-administrative. Shqyrtimi i tyre bëhet mbi bazë të dokumentacionit, evidencave dhe më pas merret vendimi për pranimin apo refuzimin e tyre nga Komiteti përkatës. Ky vendim i përcillet studentit në rrugë elektronike ose verbalisht nga SAO. Aneksi 5.30.			
Konkluzione	GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore konstaton se UNYT në përputhje me statutin dhe aktet ligjore, garanton përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse institucionale. Studentët marrin pjesë në Këshillin Disiplinor, Senatën Akademik, njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, Këshillin e Etikës, Unionin Studentor, si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm gjatë akreditimit. Përmes pyetësorëve të vlerësimit të zhvilluar çdo semestër, ata japin sugjerime për përmirësimin dhe rishikimin e kurrikulave. Studentët kanë gjithashtu të drejtën e ankimimit dhe peticioneve, të cilat trajtohen nga Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) dhe shqyrtohen nga komitetet përkatëse, me vendimet që u komunikohen drejtpërdrejt studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UNYT bazuar në statutin, rregulloren e Universitetit dhe rregulloren e Çështjeve studentore ka të përcaktuara procedurat e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve Zyra e Çështjeve Studentore (SAO). Bazuar në Aneksin 1.1;1.7;5.1
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Studentët janë të informuar mbi programin, strukturën, tarifën e studimit, kohëzgjatjen e programit me anë të mjeteve të tilla si email; takin në zyrë ose nëpërmjet ëebit zyrtar të institucionit. Në javën e parë të vitit akademik studentët informohen për sezonin e provimeve, mënyrën e vlerësimit në mënyrë më të detajuar për secilën lëndë. Gjithashtu SAO inform studentin në lidhje me planin mësimor; modulet; përmbajtjen e lëndëve që janë pjesë e programit. Cdo fillim simestri studentët njihen me syllabusin e lëndëve që do të ndjekin. Studentët kanë një këshillues akademik që bashkëpunon me SAO për informimin sa më të mirë të studentëve. Aneksi 3.4;5.1

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Bota akademike dhe ajo e biznesit kanë ura lidhëse për një komunikim efektiv me synimin e hapjes së mundësive për prezantimin e studentëve në tregun e punës local dhe ndërkombëtar. Gjithashtu UNYT ka ngritur zyrën e karrierës me synimin e zhvillimit të aftësive të studentëve për ti orientuar ata drejt trgut të punës, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera. Aneksi 5.11; 5.16;5.19(1-2)			
Kriteri 4. Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e karrierës dhe Alumni ndjek studentët pas diplomimit (ky është viti i parë që ky program nxjerr të diplomuarit e parë), mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Të gjitha këto të dhëna janë pjesë e një database, dhe pjesë e dokumentit të performancës (e cila punohet nga Sekretaria Mësimore, zyra e Karrierës dhe Alumni). Zyra e karrierës ndan informacionin me të gjithë përgjegjësit e departamenteve për të parë mundësin e punësimit në ndonjë rast që ska filluar ende punë, dhe të mbajnë komunikim me Alumnit apo me kontaktet e industrisë dhe insitucioneve të ndryshme për mbështetje e studentëve. Aneksi 5.17.1 5.18;5.19;5.20;5.23			
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore konstaton se UNYT, në bazë të statutit dhe rregulloreve përkatëse, ka ngritur Zyrën e Çështjeve Studentore (SAO), e cila informon studentët për programet, tarifat, strukturën, planin mësimor dhe mënyrat e vlerësimit, si dhe u siguron atyre mbështetje përmes këshilluesve akademikë. Studentët njihen çdo fillim semestri me syllabusin dhe detajet e lëndëve që ndjekin. Paralelisht, Zyra e Karrierës dhe Alumni shërben si urë lidhëse me tregun e punës, duke orientuar studentët për praktikat profesionale, zhvillimin e aftësive dhe punësimin. Kjo zyrë mbledh dhe përpunon të dhëna mbi gjendjen e punësimit të të diplomuarve, i ndan me departamentet dhe mban kontakte të vazhdueshme me alumnit dhe industrinë për mbështetje e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	IAL ka hartuar Strategjinë e mësimdhënies & mësimnxënies për të përmbushur objektivat e stafit akademik, e cila parashikon rishikimin periodik të kurrikulave për çdo program studimi, në mënyrë që të përmbushen nevojat e tregut dhe të nxitet zhvillimi i metodologjive të reja të mësimdhënies, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit si edhe metodave të vlerësimit për periudhën 2020–2025 dhe 2026–2030, me synimin e arritjes së nivelit të lartë akademike dhe përafrimit me standardet të edukimit. UNYT synon të kombinojë strategjinë afatgjatë, trajnimin e stafit të organizuara nga ekspertë vendas dhe të huaj mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjive të reja në procesin mësimor, përdorimin e teknologjive në procesin mësimor bashkëkohore dhe përvojat ndërkombëtare, për të garantuar cilësi të lartë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke i përafruar programet me nevojat e tregut dhe duke forcuar pozicionin e universitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Njësitë bazë të UNYT luajnë një rol kyç në këtë proces, duke përcjellë përvojat e fituara nga trajnimi tek kurrikulat, praktikat didaktike dhe organizimi i lëndëve. Përmes raportimeve të rregullta, analizohet ndikimi i këtyre metodave në rezultatet e studentëve dhe identifikohen nevojat për përmirësim. Procesi është i dokumentuar dhe i monitoruar sipas politikave dhe procedurave të institucionit, duke siguruar transparencë dhe efektivitet. Evidenca Aneksi 1.6(1);1.28;6.12;6.18
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Strukturat përgjegjëse të miratuara dhe që zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të cilësisë së mësimdhënies të personelit akademik dhe ndihmësakademik është Komisioni i Përherëshëm i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë (KPSSC) e cila është përgjegjëse për kordinimin e procedurave të përgjithëshme, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive bazë dhe njësive kryesore në mbështetje të studentëve si edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). KPSSC ka në përbërje shtatë veta, kryetari dhe 6 anëtar që janë përfaqësues të njësive kryesore dhe student. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë harton pyetësorë për studentët të cilët vlerësojnë personelin akademik dhe lëndën të cilën po ndjekin. Këta pyetësorë kryhen dy herë në vit. Për personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie për herë të parë në UNYT, vlerësimi nga studentët aplikohet dy herë në semestër. Rezultati i performancës për stafin akademik i vihet në dispozicion rektoratit, Drejtorëve të Njësive Kryesore, Drejtorit të Njësive Bazë si dhe pedagogëve përkatës, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe vënien në pah të nevojave dhe sugjerimeve të studentëve. Në nivel njësie bazë Departamenti përfshihen në Raportin Vjetor të Departamentit përveç pyetësorëve të plotësuar nga

	studentët, ndjek vlerësimin periodik të personelit akademik dhe ndihmës-pedagogjik për monitorimin dhe përmirësimin e aftësive të stafit në procesin mësimdhënës, aplikon edhe mekanizma të tjerë monitorues politika sic është procesi i vlerësimit të kolegëve që ka si synim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse. Procesi i vetëvlerësimit përfshin evidentimin e arritjeve dhe sfidave nga vetë anëtarët akademikë, të cilët bazuar në to ndërmarrin hapa për përmirësimin e mëtejshëm. Diskutimi mbi këto rezultate realizohet kryesisht në praninë e Drejtorit të Departamentit dhe në nivel më të lartë në Këshillin e Fakultetit. Evidenca Ankesi 1.1; 1.15(1-4);2.1 3.26.3;6.1;6.3;6.5;6.9(1-2)
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UNYT garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies përmes pyetësorëve anonimë, me synim grumbullimin e sugjerimeve dhe pakënaqësive për përmirësimin e institucionit. Gjithashtu, është krijuar një mekanizëm online/on site për peticione dhe ankesa, me qëndër studentin, me natyrë akademike dhe administrative që të njihet me pakënaqësitë dhe kërkesat e studentëve, të cilat trajtohen nga një komision i përhershëm i Senatit Akademik që vendos për zgjidhjen apo orientimin e duhur të rasteve. Evidenca Aneksi 1.15(1-4);3.26;3.2.1;6.5;6.7;6.9
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm bëhen publike në faqen zyrtare të UNYT-së në kuadër të transparencës nga ana e NJSBC, KPSSC. Në fund të cdo simestri bëhen publike nga NJSBC dhe raportet simestrale që përmbajnë dhe rezultatet e pyetësorëve në rang departamenti në webin zyrtar të UNYT.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit, një prej tyre është ajo e plotësimit nga cdo anëtar i stafit të planit vjetor individual në aspektin e mësimdhënies dhe rritjes së tyre profesionale me objektiva të qartë në kërkim shkencor për një cilësi të lartë të shërbimit arsimor. Drejtuesi i Departamentit rezultatet e marra nga secili staf gjatë planit vjetor i percjell tek Dekani i Fakultetit duke plotësuar një raport vlerësimi të performancës individuale me komente, sugjerime për promovimin e praktikave të mira, që nxisin personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe që i përcillet Rektoratit. UNYT mbështet dhe promovon stafin akademik për pjesmarrje në konferenca, publikime cilësore shkencore duke alokuar një buxhet specific. Rektorati pas shqyrtimit të raportit në bazë të përfundimeve vendos për promovimin e stafit akademik. Një instrument tjetër për promovimin është dhe takimet me këshillin e fakultetit, departamentit, takimet personale me stafin akademik, vlerësimi nga kolegët dhe studentët. Evidenca Aneksi 3.22;3.7.1; 4.29;6.4;6.6;6.9;6.10
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) ka hartuar Strategjinë e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies për periudhat 2020–2025 dhe 2026–2030, duke parashikuar rishikim periodik të kurrikulave dhe zhvillimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies, me synim përafrimin me standardet akademike dhe nevojat e tregut. UNYT e mbështet këtë proces përmes trajnimeve të stafit nga ekspertë vendas dhe të huaj, integritetit të teknologjive moderne dhe</i>

	përvojave ndërkombëtare. Procesi zhvillohet në nivel njësisht bazë e kryesore, ku përmes raportimeve, analizohen rezultatet e studentëve dhe identifikohen nevoja për përmirësim. Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë realizohen nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë (KPSSC) dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), që hartojnë edhe pyetësorë për vlerësimin e stafit nga studentët. Këto vlerësime zhvillohen dy herë në vit dhe shërbejnë për përmirësimin e praktikave mësimore. Në nivel departamenti, procesi mbështetet edhe nga vlerësimi i kolegëve dhe vetëvlerësimi i stafit akademik. Studentët janë të përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në vlerësimin e cilësisë përmes pyetësorëve dhe mekanizmave të ankesave/peticioneve online ose në vend, të cilat trajtohen nga komisionet përkatëse. Rezultatet e vlerësimeve dhe raportet e jashtme publikohen rregullisht në faqen zyrtare të universitetit, duke garantuar transparencë. Gjithashtu, çdo anëtar i stafit plotëson planin individual vjetor për mësimdhënie dhe zhvillim profesional, i cili analizohet nga drejtuesit dhe i përcillet rektoratit për vendimmarrje mbi promovimin, mbështetjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të stafit. Universiteti financon pjesëmarrjen në konferenca dhe publikime shkencore, duke forcuar cilësinë e shërbimit arsimor dhe reputacionin e tij akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UNYT ka më shumë se 20 vite që operon në këtë fushë dhe bazuar në Statutin e saj(neni 58), Planin Strategjik 2020-2025, ka ngritur dy struktura KPSSC, NJSBC që ndjekin procedurat dhe politikat bazuar në politikat, ligjet dhe aktet rregullatore që të merren me procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me praktikat më të mira kombëtare dhe treguesit më të lartë të performancës. Këto dy struktura KPSSC dhe NJSBC operonë bazuar në Manualin e sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloreve përkatëse për këto proceduar. Evidenca Aneksi 1.1; 1.6;1.6.1; 6.3 ;6.7
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	IAL ka ngritur strukturat NJSBC dhe KPSSC bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutit Institucional, Aktet rregullatore specifike dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë, qëllimi i tyre është pikërisht sigurimi i cilësisë së brendshme. Në përbërje të tyre janë stafa akademik dhe student apo ekspertë të jashtëm me experience në sigurimin e cilësisë së edukimit. Senati akademik zgjedh KPSSB me mandat 2 vjeçar dhe misioni i tij është i qartë zhvillimi dhe forcimi i sistemit të cilësisë në UNYT. Në bashkëpunim me NJSBC kordinojnë procedurat që njësitë akademike dhe ato mbështetëse të studentëve duhet të garantojnë për pëpruthshmëri me

	kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. NJSBC në bashkëpunim me departamentet e fakultetit organizon formën finale të vlerësimit të performancës së pedagogut për cdo lëndë dhe program. Pjesë e këtij procesi janë dhe studentët si organizatorë, si aktorë gjatë ndjekjes së lëndëve dhe vlerësimit të profesorëve. Pyetësorët organizohen cdo simestër, për lëndët që pedagogët japin lidhur me metodologjinë e përdorur, literaturën etj. Këto të dhëna që mbledhen nga pyetësi përpunohen nga koordinatori i NJSBC dhe i dergohen fakulteteve përkatëse me synim rritjen e cilësisë, zbatimin e standarteve dhe arritjen e objektivit ku përfitues janë studentët. Format e vlerësimit për pedagogët janë: vlerësimi nga studentët, nga kolegët, performance individuale; raporti i paanshmërisë, transparencës, krahasueshmërisë auditimit dhe raporti i të dhënave të kërkimit shkencor. Të gjitha aktivitetet përfshihen në raportin vjetor të departamentit në të cilin kontribuojnë jo vetëm NJSB, por edhe ekspertë të jashtëm sipas nevojave të UNYT me synim përmirësimin e sigurimit të cilësisë. Evidenca Aneksi 1.1;2.1;3.19.1;3.30; 6.1;6.3;6.5; 6.7;6.9;6.9(1-2); 6.10.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Rregullat e përcaktuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, që është dokumenti bazë për të ndjekur të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të arsimit lartë, gjithashtu standartet europiane dhe ndërkombëtare përdoren nga UNYT për vlerësimin e jashtëm të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimxënie, gjithashtu duke u bazuar dhe në rregulloret e hartuara nga IAL të cilët përdorin dhe mekanizma si peticione; vlerësime të kryqëzuara staf-staf- staf-studentë-vetëvlerësim për të siguruar një mërrdhënie të ngushtë bashkëpunimi dhe mbikqyrje për të siguruar kontrollin dhe balancat e instrumentave për sigurimin e cilësisë. UNYT është riakredituar insitucionalish nga ASCAL në bazë të vendimit të Bordit të Akreditimit nr.61 datë 18.12.2020, gjithashtu është në proces akreditimit insitucional dhe nga Agjencia Turke Yokak pasi në 2018 UNYT ka kaluar në pronësi të Fondacionit Turk Maarif dhe subjekti është i autorizuar të kryej dhe shërbime arsimore jashtë vendit. IAL ka një akreditim 5 vjeçar nga ACCA për programin e studimit të MSC-Finance dhe Kontabilitet. UNYT harton plane veprimi për të ndjekur ecurin e rekomandimeve që lihen nga institucione të ndryshme duke qënë se po akreditohet për herë të parë. Evidenca Aneksi 1.15; 1.5; 6.1; 6.3;6.7;6.9.2;6.11; 6.11.1; 6.19;
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni UNYT përdor tregues të qartë sic janë raportet me të dhënat që gjeneron NJSBC ku evidentohen pikat e forta dhe pikat e dobëta të Universitetit. Format e vlerësimit të stafit akademik nga studentët dhe format e tjera të vlerësimit janë tregues të matshëm në mësimdhënie në bazë të vlerësimit të studentëve për lëndët përkatëse, për pasqyrimin gjendjes arritjet dhe dobësi që gjithashtu pasqyrohen në raportet vjetore të mësimdhënies, të nxënësve, raportet e paanshmërisë, transparencës, Krahasueshmërinë dhe Auditimi që hartohet nga Departamentit në lidhje me standardet për një cilësi të parashikuar sipas akteve rregullatore institucionale. Mekanizmi i raportimit të të dhënave shkencore, kontributi në kërkim, në projekte është pjesë e punës së stafit në UNYT që pasqyrohet në raportin vjetor. Të tjera instrumenta janë focus grupet; pyetësorët për evidentimin dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie

	sidomos nga profesorët e rinj, të cilëve ju mundesohen sygjerrime në lidhje me përmirësimet në mësimdhënie. Evidenca Aneksi 1.16;3.19.1; 6.4;6.9; 6.9.1;6.9.2; 6.10;			
Konkluzione	GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore rezultojnë se UNYT ka mbi 20 vite eksperiencë dhe ka ngritur struktura të posaçme për sigurimin e cilësisë së brendshme (KPSSC dhe NjSBC), të cilat funksionojnë mbi bazën e Statutit, Ligjit për Arsimin e Lartë, akteve rregullatore dhe Manualit të Sigurimit të Cilësisë. Këto struktura përbëhen nga staf akademik, studentë dhe ekspertë të jashtëm dhe kanë mision zhvillimin dhe forcimin e sistemit të cilësisë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi i vlerësimit të cilësisë përfshin instrumenta si pyetësorë studentorë çdo semestër, vlerësime nga kolegët, raportet e transparencës dhe auditimit, si dhe vetëvlerësime. Rezultatet përpunohen nga NjSBC dhe u përcillen fakulteteve për përmirësim të mësimdhënies dhe përfitim të studentëve. UNYT është riakredituar nga ASCAL (2020), është në proces akreditimi me agjencinë turke YÖKAK dhe ka akreditim 5-vjeçar nga ACCA për programin MSc Finance & Accounting. Institucioni përdor mekanizma të qartë raportimi, raporte vjetore të mësimdhënies, të nxënies dhe kërkimit shkencor, si dhe instrumente shtesë si fokus-grupe e pyetësorë për pedagogët e rinj, duke synuar përmirësim të vazhdueshëm dhe përafrim me praktikën më të mira ndërkombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të	Institucioni i arsimit të lartë ka ndërtuar struktura, mekanizma/ procedura që përdoren nga secila njësi në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të cilat janë të qarta dhe të përcaktuara në fillim të vitit akademik në nivel Departamenti dhe të miratuara nga Rektorati me synimin e përmbushjes së objektivave të mbikëqyrjes periodike të programeve të studimit si dhe të përmirësimit të personave për secilin staf akademik. Mekanizma të proceseve formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij janë raportet që mbahen si rezultat i planit të veprimtari në fillim të vitit akademik dhe që bëhen pjesë e Raportit Final Institucional dhe që miratohen nga Senati Akademik dhe më pas dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.

njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit duke siguruar një process transparent dhe gjithëpërfshirës. Evidenca bazuar në Aneksin 1.15.4 dhe 6.8
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Me synimin e përmirësimit të cilësisë së programit në UNYT realizohen vlerësimet e performancës së pedagogëve nga studentët, vlerësimi për kolegët si dhe procedura për vetvlerësimin e performancës, që janë pjesë e instrumentave të cilësisë duke analizuar rezultatet e pritshme të cilat dokumentohen në raportet semestrale të vlerësimit dhe që bëhen pjesë e raportit vjetor të hartuar nga Drejtuesi i Departamentit të programit , motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, adresimin e mangësive me synimin e përmirësimit të tyre . Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me Drejtuesin e Departamentit monitorojnë procesin që të jetë në përputhje me Kodin e Cilësisë. UNYT ka promovuar personelin akademik në pozicione të larta të menaxhimit bazuar në rezultatet e studentëve nëse kanë qënë shumë të mira si edhe në bazë të performancës së lartë akademike, kontributi i tyre në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programit. Studentët motivohen nëpërmjet sistemi të aplikimit për bursa kur ata kanë arritje të larta gjatë procesit mësimor, ose bëhen pjesë e punës së studiove të projekteve sipas referimit. Evidencë Aneksi 1.15.4;1.7;4;29;5.7; 6.9(1-2)
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve të cilat realizohen çdo semester, por për stafin e ri akademik vlerësimi realizohet 2 herë në vit. Një nga metodat e Vlerësimit është vëzhgimi në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime të ndërmjetme, finale, rezultatet e arritura në këto testime etj. Në UNYT vlerësimi i pedagogëve realizohet përmes feedback-ut nga studentët dhe kolegët, si dhe përmes instrumenteve shtesë si seminarët akademike, rishikimi i syllabuseve dhe mbështetja e qendrave kërkimore. Vlerësimet individuale u dërgohen profesorëve me mënyrë elektronike dhe publikohen në faqen e web-it, duke synuar transparencë dhe shmangie të abuzimeve. Procesi i vlerësimit nga kolegët ka për qëllim identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të stafit, përmirësimin e teknikave të mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të pedagogëve. Gjithashtu, për të garantuar cilësinë e mësimdhënies dhe përputhjen me nevojat e tregut, përdoren studime dhe anketa të ndryshme mbi studentët, punësimin dhe këshillimin akademik. Në thelb, sistemi i UNYT kombinon vlerësimet studentore, kolegjale dhe institucionale për të nxitur përmirësim të vazhdueshëm në cilësinë e arsimit dhe për të mbështetur zhvillimin profesional të stafit akademik. Evidenca Aneksi 2.8;3.4;6.4; 6.9(1-2)
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së	Në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, UNYT përdor instrumente të ndryshme duke përfshirë studentë, të diplomuar, staf akademik e administrativ. Qëllimi është rritja e cilësisë së arsimit,

programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	përmirësimi i programeve dhe lidhja më e fortë me tregun e punës. Një rol të veçantë luan Zyra e Karrierës dhe Alumni, e cila organizon takime, panele e panairë pune e karriere, duke ofruar mundësi të vazhdueshme për studentët dhe ata që pritet të diplomohen sepse është brezi I parë që diplomohen këtë vit. Gjithashtu, studentët marrin pjesë në sondazhe kombëtare për të vlerësuar cilësinë e studimeve në bashkëpunim me ASCAL ku ata kanë marrë pjesën në 2022 për sondazhin kombëtar të studentëve, ata janë pjesë e eventeve shkencore dhe sociale që nxisin rekrutimin e tyre dhe që organizohen nga UNYT duke ftuar kompani të biznesit që lidhen me profilin e studimit të studentëve. UNYT kombinon sondazhet, aktivitetet e alumnit dhe panairët e karrierës për të monitoruar cilësinë e studimeve dhe për të forcuar lidhjen e studentëve me tregun e punës. Evidenca Aneksi 5.15(1-2); 5.16(1-2) 5.17(1-2) 5.21			
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore konstaton se. Institucioni i Arsimit të Lartë (UNYT) ka ndërtuar struktura dhe mekanizma të qartë për mbikëqyrjen e vazhdueshme të programeve të studimit dhe për zhvillimin profesional të stafit akademik. Proceset e formalizuara dhe të dokumentuara, të miratuara nga Rektorati dhe Senati Akademik, përfshijnë raportime periodike, analiza të arritjeve e dobësive dhe plane për përmirësim, të cilat i bëhen të njohura autoriteteve përkatëse duke siguruar transparencë. Vlerësimi i cilësisë realizohet përmes feedback-ut të studentëve, kolegëve dhe vetëvlerësimit nga pedagogët, si dhe me instrumente shtesë si seminarët akademike, rishikimi i syllabuseve dhe mbështetja nga qendrat kërkimore. Studentët motivohen me bursa dhe përfshirje në projekte, ndërsa performanca e stafit ndikon në ngritjet akademike dhe menaxheriale. Për cilësinë e mësimdhënies përdoren metoda të drejtpërdrejta si vlerësime të kurrikulës, të mësimdhënies, provimeve e detyrave, vëzhgime në auditor dhe rezultate testimesh, me frekuencë më të lartë për stafin e ri. Në kuadër të lidhjes me tregun e punës, Zyra e Karrierës dhe Alumni organizon takime, panele dhe panairë karriere, duke i ofruar studentëve dhe të diplomuarve mundësi punësimi dhe rrjete profesionale. Gjithashtu, studentët marrin pjesë në sondazhe kombëtare për vlerësimin e cilësisë së studimeve në bashkëpunim me ASCAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në	Institucioni ka parashikuar dhe ka garantuar cilësinë nëpërmjet politikave dhe procedurat e brendshme duke ngritur Komisionin e Përhershëm të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

67

politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimit të Cilësisë që përbëhet nga 6 anëtar, të cilët janë përfaqësues të fakulteteve dhe student. Kjo strukturë e krijuar ndjek monitorimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit duke përdorur mekanizma të tillë si Manualin e Procedurave dhe afateve të vlerësimit në cilësisë në kuadër të akreditimit të institucionit të arsimit të lartë si edhe në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë. Pjesë e sigurimit të cilësisë së brendshme është dhe ngritja e Njësisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë e cila përbëhet nga dy anëtarë të stafit administrativ, por UNYT angazhon dhe ekspert të jashtëm me eksperincë për angazhimin në aktivitete që ndikojnë në sigurimin e cilësisë në Arsimin e Lartë. Manuali i UNYT shërben si rregullator për garantimin e cilësisë. Evidenca Aneksi 1.1.1; 6.1; 6.3;6.5;6.7
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	IAL nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë të Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë si edhe Njësisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë harton plan verpimi për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi Akreditimit për çdo program mbi bazën e detyrave konkrete që ata kanë, bazuar në rregulloren e organizimit të punës së tyre, e cila është në konformitet me Ligjin për Arsimin e Lartë, Manualin e Cilësisë si edhe Statutin e Universitetit Neë York në Tiranë. Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë në fillim të vitit akademik harton planin e veprimit ku janë të shkruara detyrat dhe përgjegjësitë vjetore. Evidenca Aneks 6.1;6.2;6.2.1;6.3;6.7;6.16;6.16.1
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në sigurimin e cilësisë së programit të studimit në UNYT Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë si edhe Njësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë së bashku me Dekanët dhe drejtuesit e Fakulteteve janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë dhe monitorimin e tij për përmirësimin e vazhdueshëm. Në procesin e vlerësimit përfshihen studentët që vlerësojnë mësimdhënien dhe nxënien, stafi akademik dhe ndihmës akademik të cilët vlerësojnë njëri tjetrin për të përmirësuar teknikat më efektive që studentët të përthithin sa më shumë. Ky vlerësim ndikon në strategjinë e mësimdhënies për t'u përmirësuar në vijim. Njësit kryesore aplikojnë transparencë për ndonjë gabim të mundshëm në korrigjimin e provimeve dhe një ndërveprim midis studentëve dhe stafit akademik me synimin e zgjidhjes reale të rasteve. Evidenca aneksi 6.4;6.9dhe 6.10 gjithashtu dhe takimi me studentët në diskutimin midis nesh.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KoGaSC) përbëhet nga 5–7 anëtarë të zgjedhur nga Senati Akademik, me mandate të rinovueshme, ku përfshihet edhe një përfaqësues i studentëve. Kjo strukturë siguron përfaqësimin e gjerë të njësive akademike, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm, duke garantuar gjithëpërfshirje, respektojë integritetin akademik dhe transparencë. Për më tepër, UNYT ka hartuar Kodin e Etikës, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, për të parandaluar çdo formë diskriminimi apo pabarazie ndaj stafit dhe studentëve. Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit në UNYT, është e garantuar përfshirja e njësive

	kryesore, personelit akademik e administrativ, si dhe e studentëve. Evidenca Aneksi 3.1; 6.3;6.20			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë edhe bashkëpunëtorët dhe IAL si partnere në projektin Erasmus+; QAinAL (Projekti QAinAL PLUS synon të forcojë strukturat e sigurimit të cilësisë (QA) brenda institucioneve private të arsimit të lartë (PHEIs) në Shqipëri. Projekti fokusohet në zhvillimin dhe mbështetjen e sistemeve të sigurimit të cilësisë, përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe sigurimin e përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe evropiane. Ky project perfshin trajnimin e stafit dhe nxitjen e bashkëpunimit midis universiteteve dhe palëve të interesuara për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm arsimor. UNYT merr në konsideratë komentet/ reagimet e stafit- studentëve , apo reagime nga komuniteti biznesit ai profesional, aty ku janë punësuar studentët e UNYT si dhe normat e punësimit që zyra e Karrierës apo Alumni kanë nxjerrë nga studimi tregut për të ndikuar në përmirësimin e praktikave më të mira të cilësisë. Ekspertët e jashtëm realizojnë vlerësime periodike të procesit të akreditimit të programeve dhe në këtë kontekst UNYT i kushton vëmendje të vecantë sugjerimeve dhe rekomandimeve të cilat kthehen në plan veprimi si pjesë e raportit vjetore për tu ndjekur nga Komisioni Cilësisë dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Evidenca Aneksi 5.10;5.17;5.17.1; 5.20;6.2(1-3)			
Konkluzione	GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore konstaton se Institucioni ka ngritur struktura të posaçme për garantimin e cilësisë, si Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, që përfshijnë përfaqësues nga fakultetet, stafi administrativ, studentët dhe ekspertë të jashtëm. Këto struktura monitorojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht cilësinë e programeve të studimit, duke u bazuar në Manualin e Procedurave, Kodin e Cilësisë dhe ligjin për arsimin e lartë. Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës, duke përfshirë studentët, stafin akademik dhe ndihmës-akademik për të rritur efektivitetin e mësimdhënies dhe nxënies. Sigurohet transparencë në vlerësim dhe bashkëpunim i ngushtë për zgjidhjen e problematikave. UNYT gjithashtu është pjesë e projektit Erasmus+ QAinAL PLUS, i cili synon forcimin e strukturave të sigurimit të cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri, duke ofruar trajnime për staf, ngritjen e zyrave të sigurimit të cilësisë dhe nxitjen e bashkëpunimit me aktorët e jashtëm. Komentet e studentëve, stafit dhe tregut të punës përdoren për të përmirësuar praktikën dhe për të përshtatur programet me kërkesat bashkëkohore. UNYT ka miratuar Kodin e Etikës për të garantuar barazi dhe shmangien e çdo forme diskriminimi ndaj studentëve dhe stafit. Ekspertët e jashtëm realizojnë vlerësime periodike, sugjerimet e të cilëve kthehen në plane konkrete veprimi që ndiqen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UNYT ka ngritur një sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit bazuar në politikën, strategjinë e zhvillimit për vitin 2020-2025 dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të transparencës dhe publikimin e tyre për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Veprimtaria është transparente për të gjithë grupet e interesit akademik, student, administratë pranë IAL-së. Programi me fokusin kryesor të Institucionalizimit, Ndërkombëtarizimit, Digjitalizimit dhe kërkimit shkencor si pjesë e programit të studimit janë në përputhje me aktet rregulloret dhe raportet e vlerësimit të cilat publikohen dhe lehtësisht gjenden në web-in e IAL-se., Evidencë aneksi 1.6; 1.61.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UNYT publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale në çeb-in e universitetit në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale, të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren Themelore të UNYT. Të dhënat u dërgohen pedagogëve, përpunohen në mënyrë elektronike si dhe komentet përkatës pasi lënda të ketë përfunduar plotësisht dhe konkluzionet, duke ruajtur konfidencialitetin si dhe në mënyrë të detajuar në zbatim të rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Evidenca Aneksi 6.9 (1-2)
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vetëvlerësimit të UNYT-së shoqërohen me një plan masash që pasqyrohet në raportin vjetor të Departamentit, si pjesë e plan buxhetit që aprovohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, të cilat adresojnë dhe synojnë përmirësimin e kushteve të mësimdhënies, mësimnxënies, gjithashtu përfshihen dhe nevoja akademike dhe operacionale e departamenteve. Evidenca Aneksi 3.22.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në përputhje me misionin UNYT harton çdo vit një raport vjetor të veprimtarisë të procesit të mirëmbajtjes së sigurisë dhe cilësisë në mënyrë të vazhdueshme duke filluar nga Departamenti- Komisioni I përherëshëm dhe Njësia e Sigurimit të cilësisë duke konsideruar seknarët e rritje së numërit të studentëve. Kjo ndoshta është pikë e dobët e UNYT -sepse kostot nuk mund të përballohen nga të gjithë vendasit, apo Anglishtja mund të mos jete në nivelet për përthithjen e mësimnxënies. Gjithësesi UNYT është duke punuar me mekanizmat e saj, eksperiencën e fituar në vitë të ruaj këtë veprimtari dhe cilësi. Evidenca Aneksi 6.2(1-3)
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka organizuar veprimtari periodike të tilla si ftesa kundrejt ekspertëve akademik/joakademikë me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre lidhur me ambientet e zhvillimit të mësimin. Shkëmbimin e informacionit dhe njohurive për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, gjithashtu ka ndikuar pozitivisht për cilësinë dhe trajnimit nga ASCAL për rëndësinë që ai ka në të vërtetë. Gjithashtu UNYT realizuar udhëtime në terren, pjesëmarrje në projekte kërkimore lidhur me shkëmbimin e njohurive dhe

	organizimin në kompeticione, panairë brenda dhe jashtë vendit të ndryshme ku stafi akademik, administrative dhe ai ndihmës akademik janë pjesë e rëndësishme e promovimit të UNYT. Evidenca janë Aneksi 3.28.1; 5.6; 5.6.1; 6.15.1; 6.17.			
Konkluzione	GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bazuar në gjetjet e evidentuara konstatohet se UNYT ka ngritur një sistem të mirëfilltë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programet e studimit, i cili bazohet në politikat dhe strategjinë e zhvillimit 2020–2025, duke garantuar transparencë dhe akses publik për studentët dhe grupet e interesit akademik. Programet kanë si bosht kryesor institucionalizimin, ndërkombëtarizimin, digjitalizimin dhe kërkimin shkencor, në përputhje me aktet rregullatore dhe raportet e vlerësimit, të cilat publikohen në ëeb-in institucional. Rezultatet e vlerësimeve të programeve publikohen duke respektuar etikën akademike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa komentet dhe përfundimet shpërndahen pedagogëve përkatës pas mbylljes së lëndëve, duke ruajtur konfidencialitetin. Procesi i vetëvlerësimit shoqërohet me plane masash që pasqyrohen në raportin vjetor të departamenteve dhe buxhetin e miratuar nga Senati dhe Bordi i Administrimit, duke adresuar nevojat akademike e operacionale dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies e mësimnxënies. UNYT përgatit çdo vit një raport të sigurt dhe cilësor, në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse dhe komisionet përkatëse, duke marrë në konsideratë rritjen e numrit të studentëve dhe sfidat që lidhen me kostot dhe nivelin e gjuhës angleze. Institucioni zhvillon aktivitete periodike me ekspertë akademike dhe joakademike për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit mbi cilësinë, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në projekte kërkimore, vizita studimore, kompeticione dhe panairë kombëtare e ndërkombëtare. Këto veprimtari kanë ndikuar pozitivisht në forcimin e cilësisë së programeve dhe promovimin e universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Arkitekturë" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i New York-ut në Tiranë (UNYT)

Pikat e forta dhe afirmime:

- Programi është zhvilluar në përputhje të plotë me strategjinë, misionin dhe objektivat e UNYT.
- Adreson nevojat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, sidomos në kontekstin e BE-së.

Pika të dobta:

1. Stafi i angazhuar në programin e studimit me Msc, normalisht në kushtet kur nuk ka mjaftueshëm "Arkitekt" me gradë shkencore, rekomandohet që stafi me Msc duhet të rregjistrohet në program doktoraturë me qëllim rritjen e cilësisë. (*standardi IV.1*)
2. Në lëndën e Statikës sipas CV-së së stafit akademik rezulton se titullari që mban gradën PhD ka studiuar Arkitekturë dhe nuk mund të jetë titular i një lënde Inxhinjerie. Asistenti i lëndës së Statikës është me gradën Msc, ndërkohë që për këtë lëndë ka kandidatë që plotësojnë kriteret për të qënë titular me PhD. Të njëjtat komente si më sipër vlejnë dhe për lëndën Teori Strukturash (Arch 404) me të njëjtë titullar dhe asistent si në lëndën e Statikës. (*standardi IV.1*)

Rekomandime:

1. Në kushtet kur nuk ka mjaftueshëm "Arkitekt" me gradë shkencore, rekomandohet që stafi me Msc duhet të rregjistrohet në program doktoraturë me qëllim rritjen e cilësisë.
2. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) sugjeron të rishihen titullarët e lëndëve të Statikës dhe Teori Strukturash.
3. GVJ rekomandon që institucioni mund të angazhohet më tepër me çështje si: Ndërkombëtarizimi i programit, zhvillimi i aktiviteteve shkencore institucionale dhe me bashkëpunime ndërkombëtare, organizata profesionale, komunitetin e biznesit etj. Botime në gjuhën shqipe dhe të huaj, tituj akademik të fituar nga stafi, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, si dhe përfshirja në projekte ndërkombëtare, të cilat duhet të dëshmojnë që UNYT ka përvojën e duhur, burimet e duhura në fushën akademike, për këtë program studimi
4. GVJ rekomandon të ketë një qasje më tepër ndërkombëtare, ku mund të krijohen mundësi për bashkëpunime dhe kontakte të drejtpërdrejta në burime dhe njohuri të avancuara për shkencën, kërkimin shumë disiplinor dhe mësimdhënien, apo edhe për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UNYT.
5. Rekomandohet që IAL të zgjerojë rrjetin e saj të marrëdhënieve dhe partneriteteve, praktikat profesionale të jenë në fokus të marrëveshjeve që universiteti në bashkërendim me fakultetin dhe departamentin. Këtu përfshihen edhe marrëveshjet me komunitetin e biznesit, bashkitë në vend, si dhe me agjenci private dhe joqeveritare apo komunitete administrative të cilat kanë në fokus praktikat profesionale dhe ofertën e shërbimeve.

6. Rekomandohen të rritet numri i mobiliteteve, shkëmbimit të studenteve dhe stafit të DAD.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences / Integrated Second Level Program "Architecture" provided by the Higher Education Institution "UNYT"

Strengths and affirmations

1. The program is developed in full compliance with the strategy, mission, and objectives of UNYT.
2. Addresses the needs of the national and international market, especially in the EU context.

Weaknesses

1. The staff engaged in the MSc study programmer; normally, in conditions where there are not enough "architects" with scientific degrees, it is recommended that the staff with MSc should be enrolled in the doctoral programmer to increase quality.
2. In the Statics subject, according to the CV of the academic staff, it results that the head, who holds the PhD degree, has studied architecture and cannot be the head of an engineering subject. The assistant of the Statics subject has the MSc degree, while for this subject there are candidates who meet the criteria to be a head with a PhD, and according to the CV he does not even have experience in teaching this group of subjects. The same comments as above apply to the Structural Theory course (Arch 404) with the same head and assistant as in the Statics subject.

Recommendation

1. The External Evaluation Group (EEG) recommends that the environment can be more
1. In conditions where there are not enough "Architects" with scientific degrees, it is recommended that staff with MSc should be enrolled in the doctoral program in order to increase quality.
2. EEG suggests reviewing the heads of the Statics and Structural Theory courses.
3. EEG recommends that the environment can be more engaged than the internationalisation of the programme, the development of scientific activities in the institution and with various collaborations, professional organisations, the business community, etc. Publications in Albanian and foreign academic titles earned by staff and membership in international organisations, as well as involvement in other projects, should prove that UNYT has the right ability and the right resources in the academic field for this study programme
4. EEG recommends having an excessive approach, opportunities for work and contacts of resources in sources and advanced knowledge for science, multidisciplinary research

and teaching, or even for the organisation and continuity of professional practices of UNYT students.

5. It is recommended that the HEI should take concrete measures to increase and motivate its PAE staff to be more active in scientific conferences, symposia, publications, etc. The organisation of conferences or scientific activities by the HEI itself could serve as a regenerative engine for the academic staff, for the wider recognition and appreciation of the department, increasing the possibility of collaborations, increasing scientific research among the staff, and using these achievements in the function of implementing the study programme, within the framework of professional training, scientific research and mobility.
6. It is recommended to increase the number of mobilities and student and DAD staff exchanges.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X